



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 11 TETOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 11. OKTOBRA 2016. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Votimi për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore,
5. Votimi i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës,
6. Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me Kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës,
7. Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-117 për akreditim,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta,
10. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës,
11. Shqyrtimi i raportit mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015,
12. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2015.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice
4. Glasanje za imenovanje člana Komisije za imovinske zahteve,
5. Glasanje Nacrta zakona o strateškim investicijama u Republiku Kosova,
6. Glasanje Predloga - odluke u vezi državnog telefonskog koda Republike Kosova,
7. Glasanje Predloga - odluke u vezi aktuelne političke situacije na severu zemlje,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-117 o akreditovanju,
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-047 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-065 o autorskim i srodnim pravima,
10. Izbor člana u Tužilačkom savetu Kosova,
11. Razmatranje Izveštaja o stanju civilne službe Republike Kosova za 2015. god.,
12. Razmatranje Izveštaja rada Statističkog zavoda Kosova za 2015. god.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2016.

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni të ju adresohem me një lajm të mirë për vendin tonë, para se të vazhdojmë me seancë.

Si rezultat i diplomacisë sonë parlamentare, Kosova ka avancuar statusin e saj në Këshillin e Evropës. Duke filluar nga janari 2017, Kosova do të marrë pjesë në seancat parlamentare të Këshillit të Evropës me një delegacion të përbërë nga tre anëtarë: pozitë, opozitë dhe pakica.

Më 5 shtator të këtij viti, Byroja e Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës ka marrë vendim lidhur me zbatimin e paragrafit 13 të Rezolutës 2049/2016 për situatën e Kosovës dhe rolin e Këshillit të Evropës.

Dhe, paragrafi 13 i kësaj Rezolute parashikon ngritjen e nivelit të bashkëpunimit të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës me Kuvendin e Kosovës.

Një ditë më parë, gjatë sesionit IV të rregullt të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës, ky vendim u ratifikua me shumicë votash.

Me këtë rast, për punën dhe angazhimin më duhet t'i falënderoj nënkryetarët e Kuvendit, zotin Xhavit Haliti dhe znj. Aida Dërguti.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po shihet se kur jemi bashkë pozitë e opozitë vendi ecën përpara. Urime dhe faleminderit!

Ju njoftoj se pikat e propozuara për këtë seancë janë shtyrë nga seanca e mbajtur më 7 tetor 2016.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Fjalimi im është përgatitur më datën 7, kur ka pasur edhe një protestë të punëtorëve të KEDS-it, megjithatë meqë janë shtyrë deklaratimet e rendit të ditës, unë do ta lexoj sot fjalën time.

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Para disa ditësh, punëtorët nga të gjitha distriktet e KEDS-it prej gjithë Kosovës kanë protestuar para objektit të KEDS-it dhe të Qeverisë për shkak të largimit të tyre nga puna.

Javën e kaluar po të njëjtit punëtorë kanë ardhur në Kuvendin e Kosovës për të kërkuar zgjidhje nga ky institucion. Personalisht e kam takuar një pjesë të madhe të tyre në dyert e Kuvendit, të cilët më janë lutur që ta adresoj shqetësimin e tyre në Parlament. Prandaj, Kompania për Distributim dhe Furnizim me energji elektrike ka marrë vendim që për arsye ekonomike, teknike dhe organizative ta mbyllë Departamentin e Projekteve në Operim dhe si rezultat të gjithë të punësuarve në këtë departament u është ndërprerë kontrata e punës.

Ndërprerja e kontratave nga Bordi i kësaj ndërmarrjeje është bërë me arsyetimin se ata nuk i obligon Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, pasi nuk janë anëtarë të Odës Ekonomike, e as nënshkrues të kësaj marrëveshjeje.

Megjithatë, si kompani që vepron dhe operon në Kosovë duhet ta aplikojë edhe këtë marrëveshjeje.

Me largimin e këtyre punëtorëve, KEDS-i nuk po e respekton Ligjin e punës, në të cilin thuhet decidivisht se duhet të ruhet mundësia e angazhimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës në punë.

Janë afërsisht 100 punëtorë të kësaj kompanie, të cilët kanë mbetur pa punë, 90% e tyre me mbi 30 vjet përvojë pune në këtë kompani dhe pjesa dërmuese e tyre janë para pensionimit.

Shumica e punëtorëve të larguar nga puna kanë qenë me kontratë të përhershme të punës. Këtë ma kanë thënë edhe punëtorët me të cilët jam takuar.

Largimi i tyre nga puna do të krijojë edhe kategori të reja sociale, meqë janë mbi 100 familje të cilave do t'u rrezikohet edhe ekzistenca e tyre familjare.

Për më tepër, punëtorët kanë paralajmëruar edhe marrjen e masave radikale, protesta të vazhdueshme, si dhe hyrje në grevë urie, nëse kërkesat e tyre nuk do të merren parasysh nga Qeveria.

Prandaj, kërkoj nga Qeveria dhe ZRRE-ja që t'i marrin parasysh kërkesat e këtyre punëtorëve dhe që ta bëjnë të pamundurën që punëtorët të kthehen në vendet e tyre të punës.

KRYETARI: Faleminderit, e nderuar deputete! Por, për hir të çështjes që është e ndjeshme do të ishte mirë që kjo çështje të ishte interpelancë, ose pyetje parlamentare, ose një grup deputetësh të shikonin për gjendjen e punëtorëve, jo vetëm në KEDS.

Njomza Emini e ka fjalën, ndërkohë Ismajl Kurtesh nga Lëvizja “Vetëvendosje” i vetmi që e ka kërkuar fjalën.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të medieve,

Kosova më shumë se kurrë ka nevojë për konsensus politik. Tani ku gjithë rajoni po ecën drejt rrugës evropiane, ne ende nuk kemi lëvizje të lirë.

Liberalizimi i vizave, i shumëpritur nga qytetarët e Kosovës, u bllokua nga përfaqësuesit e tyre.

Duke pasur parasysh dëshirën e kamotshme të qytetarëve tanë për lëvizje të lirë dhe përkushtimin e institucioneve në përmbushje të të gjitha kriterëve për liberalizim, ratifikimi i Marrëveshjes së Demarkacionit me Malin e Zi, si dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit janë vënë si kushte përfundimtare për përmbylljen e procesit të liberalizimit të vizave.

Pa dyshim që lufta kundër krimit dhe korrupsionit është proces dhe si i tillë na është vënë padrejtësisht, ndërsa ratifikimi i Marrëveshjes për Demarkacion, i cili ekziston si kusht thelbësor, pa të cilin liberalizimi i vizave nuk do të ndodhë.

Pra, kriteri i cili na është vënë - ratifikimi i Marrëveshjes me Malin e Zi, për mendimin tonë është i padrejtë. Tani ai është një kusht që ne duhet ta përmbushim.

Përderisa lufta kundër korrupsionit është një kusht i vazhdueshëm, sepse realizimi i tij nuk mund të bëhet sot për nesër, ratifikimi i Marrëveshjes së Demarkacionit me Malin e zi është kusht thelbësor, pa të cilin liberalizimi nuk do të ndodhë.

Tani dështimi s'mund të mvishet askujt, pos neve, neve që jemi në këtë sallë.

Nga takimet e Komisionit për Integritet Evropian, që e kemi pasur me përfaqësues të Bundestagut, Bundestratit dhe Qeverisë Gjermane, me vete kemi marrë shumë këshilla, lëvdata, por edhe kritika.

Na është thanë troç se Kosova më nuk është fokusi kryesor i politikës së jashtme evropiane dhe se nuk jemi më në qendër të vëmendjes së Evropës.

Dhe troç na është thanë se pa ratifikim të Marrëveshjes së Demarkacionit me Malin e Zi nuk ka vendim pozitiv për liberalizimin e vizave.

Të nderuar kolegë deputetë,
Duke bërë thirrje për një zgjidhje përtej interesave të ngushta në interes të shtetit dhe qytetarëve të tij, më lejoni që sot t'u drejtohem të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës dhe veçanërisht liderëve të partive politike që të ulen dhe ta gjejnë një zgjidhje.

Kryeministri Mustafa, para ca ditëve e bëri hapin e parë dhe e ftoi një takim të përbashkët...

(Ndërprerje nga regjia)

... dhe zbutjes së ngërçit politik.

Është koha e fundit që të reflektojmë. Prandaj, ftoj veçanërisht liderët e partive opozitare që ta tejkalojnë çdo bojkot dhe kusht dhe të ulen me kreun e Qeverisë, zotin Mustafa, për ta gjetur një zgjidhje.

Mbi një vit bllokim dhe zvarritje të punës së Kuvendit, është momenti i fundit për ndryshim të qasjes drejt një gjuhe kompromisi.

Këtë ua kemi borxh qytetarëve të Republikës së Kosovës. Po ashtu, borxh ua kemi edhe qytetarëve zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe përshpejtimin e procesit integruar.

Momentet e gëzimit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje kanë kaluar. Tani duhet angazhim dhe punë konkrete e të gjithëve për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Në këtë proces shumë të rëndësishëm, Komisioni për Integritet Evropian do ta kryejë punën e vet me përgjegjësi dhe me përkushtim.

Andaj, të nderuar kolegë deputetë,

Ju ftoj që tërë energjinë tonë ta përqendrojmë në përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave dhe në mbikëqyrjen e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në orën 10:50 mbaron kjo pikë e rendit të ditës, ndërsa kemi shumë diskutues.

Glauk Konjufca e ka fjalën, ndërkohë Teuta Haxhiu të bëhet gati.

GLAUK KONJUFCA: Qytetarë të nderuar të Republikës, Deputetë të Kuvendit të Kosovës, Sesa e kontrolluar është Policia dhe Drejtësia te ne nga klani “Pronto”, mjafton të shihet se si po përdoren këto dy institucione të shtetit kundër Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Ky është vazhdim i luftës kundër “Vetëvendosjes” me mjete të tjera. Meqë nuk po mund të na luftojnë me argumente dhe me fakte, dhe me debate në rrafshin e politikës, tash me mashtrime e me procese të montuara gjyqësore po duan të na shpallin terroristë.

Kjo është shenjë që këta njerëz e kanë humbur diskutimin në rrafshin politik dhe politika më nuk është fusha e betejës. Tash janë arrestimet, burgjet dhe persekutimet.

E kanë manipuluar Policinë që të montojë prova të rrejshme, ashtu që të sajohet fajtori.

Atdhe Arifit, Astrit Deharit dhe Egzon Halitit iu dhanë edhe nga dy muaj paraburgim, kurse Adeja Batushës, Frashër Krasniqit dhe Petrit Ademit ua dhanë edhe nga një muaj tjetër arrest shtëpiak. Ata po mbahen me akuzën e fabrikuar për terrorizëm.

Vetëm një javë pasi Policia i sajoi provat dhe gjashtë aktivistët tanë u burgosën, pasoi shpërblimi nga Qeveria edhe për një mandat pesëvjeçar për Shpend Maxhunin në krye të Policisë së Kosovës. Ai u shpërblye për keqpërdorimin e Policisë kundër Lëvizjes “Vetëvendosje”!

Në Kosovë, karriera institucionale lidhet me shërbimet që ia kryen klanit “Pronto”. Sa më shumë shërbime të pista, aq më lart je në hierarki!

Rasti i gjashtë aktivistëve të arrestuar të “Vetëvendosjes” për terrorizëm, mbajeni në mend, do të dalë në fund si procesi më i montuar në Kosovën e pasluftës.

Në këtë proces janë të përfshirë urdhërdhënësit politikë, që janë Isa Mustafa, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, si dhe ekzekutuesit e tyre shërbëtorë, që janë Shpend Maxhuni, Fatos Makolli, Luan Keka dhe të tjerët e këtij soji. Nuk kam dyshim se një ditë të gjithë do të japin përgjegjësi për keqpërdorimet dhe krimet e bëra.

KRYETARI: A e kreve? Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Kryetar, unë jam në emrin tim, Time Kadrijaj është në emër të grupit.

KRYETARI: Më fal, këtë e vendosni ju. Atëherë Time Kadrijaj në emër të Grupit Parlamentar.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Fillimisht më duhet të pranoj se as për së afërmi nuk do të mund t'i paraqes të gjitha dështimet e kësaj Qeveria, por do të provoj vetëm disa më kryesoret.

T'ia rikujtoj kësaj ushtrie qeveritare, më e madhja në botë, me 21 ministra e plot 50 zëvendësministra.

E ajo me çka po ballafaqohet Kosova sot, është vërtet e dhimbshme. Edhe pse jemi vendi më i pasur nën tokë me xehe, mbi tokë me strukturën shoqërore më të re në Evropë, ne vazhdojmë të jemi vendi më i varfër, edhe se Mogadishu apo Somalia.

E kemi papunësinë në shkallën më të lartë, që shkon deri rreth 50%. Ata që janë në përqindje më të lartë dhe në këtë pikë është struktura rinore nga 20 deri 35 vjet.

Kosovën, nga një vend të bekuar nga Zoti, me pasurinë natyrore e njerëzore, po e ktheni çdo ditë në një vend ferri, duke e shtyrë me shpejtësi në ... me kokën poshtë.

Mungesa e zhvillimit ekonomik nënkupton ikje të qytetarëve nga Kosova. Ju vetë e dini që keni pasur një fillim të keq në këtë drejtim. Kur e realizuat koalicionin para dy vitesh nga Kosova për në vendet e Evropës dhe botës dolën mbi 100 mijë qytetarë. Për zhvillimin ekonomik ju edhe sot nuk keni zgjedhje të qëndrueshme. Në këtë drejtim jeni të mekur.

Nëse u referohemi raporteve të Bankës Botërore, nuk paraqitet një zhvillim i shpejtë ekonomik në vendin tonë, e ky është një alarm për Kosovën edhe për qytetarët.

Arsimi: Nëse analizohen me vëmendje të gjithë indikatorët, mund të konstatohet se sistemi arsimor është i kapur nga partitë më të mëdha që e kanë qeverisur vendin nga viti 2008.

Qeveria e Kosovës në këto tetë vjetët e fundit vazhdimisht e ka proklamuar Kosovën si shtet të dijes, por të gjithë indikatorët flasin për një sistem të politizuar skajshmërisht.

Shëndetësia është para kolapsit, e për të dalë nga kjo gjendje duhet që të fillojë implementimi i ligjeve të miratuara, si dhe shëndetësia duhet të jetë sa më larg politikës, në mënyrë që të dilet nga kjo situatë.

Keqmenaxhimi e deri te mungesa e barnave, e aspak nuk implementohen ligjet, ai për odat e mjekëve, Ligji për duhanin, Ligji për shëndetësi, Ligji për sigurimet shëndetësore, themelimi i shumë asociacioneve të tjera. Kur ia shtojmë kësaj edhe se njerëzit vendosen në vende kyçe vetëm pse janë anëtarë të një partie, pra kemi dështim total.

Siguria: Shteti ka dështuar në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ku janë këshillat nacionalë për siguri, sigurisht janë jofunksionalë dhe jotransparentë.

Nuk luftohet krimi dhe korrupsioni me task-forcë e as me tryeza të rrumbullakëta. Të gjitha task-forcat e Policisë kanë dështuar.

Nepotizmi është shtirë edhe në Polici, edhe në AKI. Këto shihen edhe në gradimet që bëhen në këto institucione. Shteti është i dobët dhe përballë zhvillimeve me fqinjët, të cilët vijnë në Kosovë e sorollaten, e lëshojnë deklaratat tendencioze dhe shkojnë nga këtu si pa të keq. Rasti i fundit me arrestimin e policit Nehat Thaçi flet mjaft.

Moskrijimi i Ushtrisë së Kosovës, që pa asnjë arsye të madhe po mbetet ende peng i kësaj Qeverie të pagximshme tregon se Kosova përballët edhe me pasigurinë në kohën kur i kemi të gjitha këto zhvillime negative në rajon e botë. Në aspektin e sigurisë as ne nuk jemi imun dhe të paprekshëm.

Investimet: Kosova vazhdon të vuajë nga mungesa e investimeve të huaja, gjë që po ndikon edhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, rrjedhimisht në pamundësinë e uljes të shkallës së papunësisë dhe varfërisë.

Vendet tona fqinja po bëjnë gjithçka që është e mundur me ligje për tërheqjen e investitorëve të huaj, i kanë avancuar ofertat e tyre për tërheqjen e kapitalit të huaj, e Kosova e ka avancuar vetëm çmimin e ryshfetit dhe korrupsionit përballë investitorëve.

Se sa keq i kemi bërë privatizimet tregon edhe largimi i fundit i shumë punëtorëve nga puna, konkretisht nga KEDS-i, që qindra familjarë i la në mëshirën e fatit.

Sot ishin dhjetëra prej tyre në protestë këtu para Kuvendit të Qeverisë dhe askush nga pushteti nuk u mor me ta. E turpshme!

Agjenda evropiane e Kosovës: Me përjashtim nënshkrimit të MSA-së, e cila dallon për Kosovën për shkak të fusnotës, në të tjera drejtime thuhet se nuk kemi aspak ecje përpara.

Në agjendën evropiane të Kosovës ende po ndikon shumë Serbia.

Qeveria e Kosovës është shumë e paaftë përballë Serbisë. Nuk ka përkushtim në mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës.

Qytetarët tanë të vetmit ende jetojnë në izoluar nga pamundësia që të lëvizin lirshëm në vendet e Evropës. Të rinjtë tanë veçanërisht presin me ditë të tëra për ta marrë një përgjigje për viza, e në shumicën e rasteve ato përgjigje janë negative. Krejt këtë kosto e paguajnë qytetarët e Kosovës shkaku i politikëbërjes së keqe të Kosovës.

Prandaj, mjaft harxhuat energji e tërë Qeveria vetëm në tri tema: për Gjykatën Speciale, Demarkacionin dhe Asociacionin, duke harruar që jeni në pushtet edhe për ta rregulluar papunësinë, sigurinë, rendin e ligjin, për të sjellë investime, për të sjellë Ligjin për sigurime shëndetësore, me një fjalë për të ofruar zhvillim për Kosovën dhe qytetarët e saj.

KRYETARI: Faleminderit! Valdete Bajrami, në qoftë se jam korrekt, në emër të Grupit Parlamentar, e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot detyrimisht më duhet të flas për dy tema, ku protagonistë është ish-lideri i PDK-së, Hashim Thaçi.

Njëra ka të bëjë me dëshminë e ish-guvernatorin të BQK-së, zotit Hashim Rexhepi, ku dje doli në pah ana e errët e Thaçit për ata të cilët nuk e kanë ditur.

Dhe tjetra me mbajtjen e një konference, ku i prezantoi disa letra, por si duket edhe një e kishte harruar që t'ia adresonte edhe atë prokurorit të Shtetit.

Është e kotë tentativa që me një thirrje të një konference t'i hedhësh hi syve popullit për mashtrimet dhe dështimet tuaja.

Ju dje me atë deklaram nëpërmjet një konference i ofenduat të gjitha viktimat. Ju i vratë edhe një herë të gjithë anëtarët e familjarëve të tyre që ranë për lirinë e vendit. Ju viktimat e gjenocidit serb i krahasuat me veprimet individuale të bëra gjatë luftës. Kjo është e papranueshme, që ju t'i shfrytëzoni viktimat e gjenocidit serb të bëra në luftën e fundit për interesa personale, për

ndreqjen e imazhit tënd, sepse e dimë që vetëm për qytetarët ju nuk mendoni, e lëre më të punoni për të mirën e tyre.

Ku ishit që sa vite zoti Thaçi? Pse nuk e keni bërë këtë veprim edhe më herët, pra kur ishit kryeministër? Apo ishit të zënë se si t'i uzurponi institucionet e pavarura, ashtu siç patët bërë me BQK-në.

Ju dje është dashur ta keni edhe një letër shtesë - letër për vetveten, letër e cila po ashtu do t'i drejtohej prokurorit të Shtetit që t'i fillonte hetimet pikërisht për ju.

Dje doli në shesh ana juaj e errët, e gjitha nëpërmjet dëshmisë së ish-guvernatorit të BQK-së, zotit Rexhepi, ku po shkruhet ndikimi i juaj në BQK nga pozita e kryeministrit, ku keni kërkuar nga ai që paratë e shtetit t'i vërë në shërbim tuajin dhe të disa individëve të partisë të cilën e drejtoje në atë kohë, PDK-në. Kjo ishte mundësuar nëpërmjet këshilltarit tuaj dhe disa zyrtarëve të tjerë, siç përmenden aty Ahmet Shala dhe të tjerëve, të cilët po ashtu përmenden në këtë dëshmi të publikuar dje.

Aty dëshmohet ndërhyrja juaj apo thënë më mirë kapja e BQK-së nga ju si lider i PDK-së.

Aty dëshmohet se ju kishit kontroll të plotë mbi paratë e qytetarëve, taksapaguesve, mbi pensionet e qytetarëve dhe ju ishit ai i cili vendoste për destinacionin e këtyre parave, por edhe kush e si duhet të përfitojë nga ato.

Pse e kundërshtuat propozimin e zotit Hashim Rexhepi? Vetëm pse jua prishi terezinë dhe si kundërpërgjigje, ju e arrestuat atë, ose dhatë urdhër ta arrestonin, se e dimë se si veprojnë organet e drejtësisë dhe sigurisë në Kosovë.

Kush ta kreu punën që nuk t'u bindë zoti Hashim Rexhepi?

Si ka shkuar procedura kur Trusti për një kohë të shkurtër, me ndihmën e dikujt tjetër, në këtë rast me refuzimin e zotit Rexhepi, vendosi t'i investojë rreth 75 milionë euro në një bankë, të quajtur "Fortis"? A ka raport se si u arrit kjo marrëveshje? A u ndatë të gjithë të kënaqur pas ndarjes së përqindjeve, pasi pikërisht këshilltari juaj atë kohë i kishte premtuar ish-guvernatorit se në rast se kryhet puna sipas instruksioneve të gjithë do të ndaheshin të kënaqur. Pra, në rast se kryhen të gjitha punët sipas kërkesës së kryeministrit të asaj kohe, Hashim Thaçi, të gjithë do të ndaheshin të kënaqur, gjithnjë kjo ishte përgjigjja për ata që e kryejnë punën siç e kërkonte Hashim Thaçi.

Pse dje nuk kërkuat ju personalisht nga prokurori t'i fillojë hetimet për dëshminë e ish-guvernatorit të BQK-së, ashtu siç kërkuat për krimet e luftës?

Ne të gjithë e dimë që Gjykata Speciale do ta ketë këtë përgjegjësi. Pra, ajo do të jetë përgjegjëse për kërkesat tuaja që ju i drejtuar te prokurori i Shtetit, prandaj mjaft me tallje, se do të vijë koha që ju personalisht do të jepni llogari për të gjitha dëmet që ua shkaktuar qytetarëve dhe shtetit. Kjo është tallja e radhës nga ju me ndjenjat e qytetarëve, pasi ju ishit ideatori, lobusi, por ishit edhe ai i cili i shtyri të gjithë deputetët e partisë tuaj që të votojnë për krijimin e Gjykatës Speciale.

Po e them prapë, se është e kotë që të tentoni ta tërhiqni vëmendjen nga dëshmia e ish-gubernatorit të BQK-së, zotit Rexhepi, i cili ka treguar për ndikimin tuaj në institucionet kryesore të parasë së shtetit. Nuk do të mund të dilni i pastër, pasi do të duhet të gjitha të ju dalin në shesh, të gjitha të këqijat, të gjitha veprimet jo të drejta të cilat i keni bërë.

Ne kërkojmë nga Prokuroria e Shtetit që ta trajtojë me urgjencë dëshminë apo deklaratën e ish-gubernatorit të BQK-së, zotit Rexhepi, e që këtu është i implikuar zoti Hashim Thaçi, ku flitet për manipulime, ndikimet e tij në financat, konkretisht në paranë e shtetit dhe të qytetarëve.

Dhe, është e kotë, sepse nuk do të funksionojë kjo metodë juaja për ndreqjen e imazhit të tuaj duke e shfrytëzuar pjesën historike, e cila u takon qytetarëve, atyre që dhanë më të dashurit për liri, sepse e tërë bota e ka kuptuar se çfarë njeriu jeni ju dhe çfarë jeni në gjendje të bëni, vetëm e vetëm që ta ruani veten dhe kolltukun tuaj. Nuk do të mund t'i ikni përgjegjësisë, ndoshta do të bëhet dikur vonë, por ju e dini se fundin e keni afër.

Dhe, deklarinimet e ditës së djeshme nga zoti...

(Ndërprerje nga regjia)

...e dëshmojnë edhe një herë që krimi i organizuar është pikërisht në instancat më të larta të shtetit dhe po dua të ndërlidhem me deklaratën e mëparshme, kur liberalizimi i vizave pikërisht do të ngecë për këtë arsye, se ju nuk mund ta luftoni vetveten dhe çështja e demarkacionit, edhe sot nëse kalon, e dinë shumë mirë kolegët të cilët kemi qenë në atë udhëtim, që na është thënë edhe nëse kalon demarkacioni, po që se nuk luftohet korrupsioni dhe krimi i organizuar, liberalizim të vizave nuk do të ketë.

Prandaj, kjo duhet t'u bëhet e qartë gjithë qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po “fundin e keni afër”, si po mendon se e ka afër presidenti aktual?

VALDETE BAJRAMI: Besoj që po të ishte këtu presidenti, do t'ia jepja atij përgjigjen.

KRYETARI: Ne jemi deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e shpeshherë po dëgjohen akuza të cilat kanë të bëjnë me natyrë tërësisht penale. E ftoj kryeprokurorin e Shtetit që të mos jetë i heshtur në raste të tilla kur ka aktakuza të drejtpërdrejta dhe të veprojë për arsye se aktualisht u përmendën me dhjetëra aktakuza në të njëjtën kohë, të cilat kanë të bëjnë me natyrën penale, por edhe nga njerëz të cilët kanë pasur dhe mund të kenë pasur edhe aktakuza. Sido që të jetë, ne është mirë ta mbajmë konotacionin politik, edhe të kritikës, edhe gjykimit ndaj njëritjetrit. Fundin veç Zoti ia jep secilit prej neve, asnjë njeri s' do të mund.

Faleminderit! Qerim Bajrami e ka fjalën.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedniĉe Parlamenta!

Poštovani predsedniĉe,

Poštovani poslanici,

Poštovani ministre Obrazovanja, doktor Arsima Bajrami,

Poštovani prisutni ministri,

Mi pripadnici nevećinske zajednice u poslednje vreme se suoĉavamo sa jednim problemom, koji imaju naši studenti, a koji su hteli da upišu master studije.

O tome je upoznat i ministar Arsim Bajrami ovih dana, a bez obzira što imamo pozitivne pomake posle donošenja administrativnom uputstva u ministarstvu, imamo dobre iskorake i na bahĉelor studijama i na masteru, meĉutim niz naših kandidata, dakle iz svih nevećinskih zajednica, se ovih dana suoĉavaju sa problemima na master studijama kao kandidati i treba to što prije razrešiti u pozitivno smeru, jer nema mnogo kandidata na nekim fakultetima oni se odbijaju iz nama nepoznatih razloga.

S obzirom da su rezervisana mjesta i za nas i za druge kategorije iz regije, dakle za Albance iz Preševske doline, Crne Gore i Makedonije i tako dalje, na neki naĉin i pozitivna diskriminacija, u ovom smislu ti studenti ne bi trebalo da budu tretirani po broju poena kao i pripadnici većinske zajednice, jer onda nema smisla rezervisano mesto, onda je kandidat ravnopravan sa svim ostalim kandidati. To je prvo pitanje.

Drugo pitanje, s obzirom da imamo ovde i ministru Arsima Bajramija, ja Źelim da ga još jednom posetim u ime svih nas ovdje da Bošnjaĉka zajednica na Kosovu neće odustati od zahtjeva za otvaranje i smeru na Ekonomskom fakultetu u Prizrenu na Bosanskom jeziku.

U poslednje vreme smo takoĉe mi poslanici, dakle ja i gospoĉa Duda Balje, završili niz tehniĉki stvari ovdje vezano za onaj deo koji treba da odradi možda ministarstvo ili ipak sam Univerzitet "Ukšin Hoti" u Prizrenu.

Na ime 29. septembra smo podneli Akreditivnoj komisiji zahtev, ispunili smo dakle potrebu da bude u roku za akreditaciju tog smera.

Takođe smo ministarstvu dali adekvatnu eventualnu izmenu administrativnog uputstvo u jednoj reči koja navodno problematična oko otvaranja i tog smera.

U međuvremeno je i Komisija za zajednica u ovom Parlamentu razmatrala taj problem i dala punu podršku i u prisustvu ministra, i pre neki dan pismenim dopisom da se ispuni ono što ovaj Parlament odlučio na rebalans budžeta i izdvojio 50 hiljade evra upravo za otvaranje ekonomskog smera u Prizrenu.

Bošnjačka zajednica nema zasebne strukture na Kosovu i da ispunjava neke navodno zasebne uslove i da pruža neke usluge, niti univerzitetu, niti MONT-u.

Bošnjačka zajednica u sistemu obrazovanja Republike Kosova, i ona administracija, i Ministarstva obrazovanja, i na univerzitetima javnim, dakle na celom Kosovu treba da ispunjava iste obaveze i prema Bošnjačkoj zajednici i prema Turskoj zajednici normalno, a ne da nešto se specijalno traži od nas. Bez obzira na to, mi smo bili spremni da redovno ispunjavamo sve tehničke zahteve, i između ostalog ponuđen je i adekvatni profesor, koji može da bude nosioc tog smera.

Dakle sve ostalo ostaje na dobro volji na Univerzitetu “Ukšin Hoti” i na Ministarstvo obrazovanja.

Još jednom napominjem da je kršenje Zakona o rebalansu budžeta ne bude li se ispoštovala volja i ovoga Parlamenta i Bošnjačke zajednica koja 3-4 godina unazad traži otvaranje ovog smera. Odgovor je bio “nemamo noca”, sad kad je ova Skupština istina sa malo problema obezbedila dodatna finansijska sredstva na rebalansu budžeta, ispada da opet ne možemo da otvorimo taj smer. Ovde dakle malo dobre volje i malo više rada u administraciji i na Univerzitetu “Ukšin Hoti” i u Ministarstvu obrazovanja. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! I nderuar Bajrami, pas përfundimit në 10:50 të pikës së parë të rendit të ditës, pastaj ministri ka kërkuar t’jua japë një përgjigje.

Tani do të shkoj në bazë të radhitjes. Zoti Abdyl Ymeri, nga Partia Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Një Tetori njihet si dita e të moshuarve dhe në shumë vende demokratike e të zhvilluara organizohen aktivitete të shumta në shenjë të respektit të moshës së tretë, e që pasqyrohen nëpërmjet mediave elektronike dhe të shkruara për angazhimin në punën dhe kontributin e tyre që kanë bërë për ta krijuar një shoqëri më të avancuar dhe më të mirë.

Pozita sociale e pensionistëve aktualë të Kosovës nuk është e kënaqshme me gjithë përpjekjet e vazhdueshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës që nëpërmjet reformës dhe skemës së re sociale t'ua përmirësojë gjendjen duke ngritur pensionet, ngritje e cila nuk është e mjaftueshme, sepse nuk i përmbush kërkesat dhe nevojat elementare të pensionistëve, sidomos të atyre familjeve që e kanë burim të vetëm pensionin e një pensionisti.

Mirëpo, politika sociale është e varur nga zhvillimi ekonomik më i hovshëm i vendit, prandaj kërkohet një strategji zhvillimore për një zhvillim të harmonizuar ekonomik social, sepse problemet sociale janë pengesë e zhvillimit, në përgjithësi.

Unë e kam shikuar dhe e kam lexuar me kujdes Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe pikërisht në nenin 16 thuhet: “Kufizimet në numrin e pensioneve të paguara, personat të cilët janë përfitues të cilitdo pension të skemës pensionale, të përcaktuar me këtë ligj, në asnjë rrethanë nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni nga skema e veçantë pensionale, të cilat menaxhohen dhe administrohen nga ministria.

Në bazë të ligjit dhe këtij neni, ministri merr vendim për ndalesë të pensioneve të familjarëve të dëshmorëve dhe martirëve dhe kategorive të tjera, të cilët i kanë marrë dy lloj të pensioneve.

Unë do ta ngre një shqetësim të të gjithë atyre qytetarëve që i kam takuar gjatë këtyre ditëve dhe kam bashkëbiseduar për këtë problematikë dhe konsideroj se ky Kuvend dhe kjo Qeveri duhet të merret seriozisht me këtë çështje dhe duhet përmirësuar këtë, sepse të gjithë ne si shoqëri duhet ta kemi të qartë dhe të kuptojmë nëse një pensionist kontributdhënës dhe pensionist që e ka pensionin e pleqërisë i merr këto pensione si rezultat i kontributit dhe si e drejtë që e fiton me këtë ligj. Kurse pensionin tjetër që e merr për djalin dëshmor apo martir, për vajzën dëshmore apo martire, të rënë anëtarin e lirisë, e merr si rezultat i angazhimit, kontributit, vepra sublime dhe flijimit të atyre për liri dhe atdhe, për një të drejtë që i takon sipas ligjit për statusin e të drejtave të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Ata dhe ato nuk kanë rënë për një pension që ta gëzojë familja e tyre, por ne si shoqëri jemi të obliguar që t'u jemi mirënjohës tërë jetën për veprën e tyre në shërbim të lirisë dhe e kemi obligim që familjet e tyre të kenë mirëqenie dhe një jetë më të mirë dhe dinjitoze.

Qytetarët me të drejtët kanë pyetur dhe pyesin dhe sigurisht edhe qytetarët në përgjithësi pyesin se si është e mundur që në këtë Kuvend dhe Qeveri dhe në institucione publike ka individë që marrin 2-3, e besa edhe 4-5 paga goxha të majme, e askush nuk merret me këtë, e na u paska dashur që të merremi me kategorinë më meritore, sepse ashtu po shkruan në ligj dhe duhet zbatuar, e për të tjerët ka apo nuk ka ligj?!

Konsideroj se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet ta sjellë këtë ligj për ndryshim dhe plotësim, në mënyrë që ta gjejmë një formë më adekuate që këto pensione të mos ndalen.

Po ashtu, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ta gjejë një formë më të përshtatshme për shpërndarjen e pensioneve dhe ndihmave sociale, në mënyrë që një herë e përgjithmonë të mos kemi rend të gjatë të pritjes së këtyre përfituesve para bankave që po paraqet një imazh jo të mirë për të gjithë ne.

Gjithashtu, Qeveria e Kosovës sa më shpejt ta procedojë Ligjin për pagat në Kuvend, në mënyrë që ta kemi një shpërndarje të drejtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë, ndërkohë ora është 10:50, i kemi 11 deputetë të cilët janë në pritje. Unë do t'ia lexoj vetëm emrat që herën e ardhshme do ta kenë fjalën: Adem Salihaj, Nait Hasani, Ismajl Kurteshi, Ali Berisha, Veton Berisha, Zafir Berisha, Albin Kurti, Luljeta Veselaj-Gutaj, Pal Lekaj, Teuta Haxhiu, Hajdar Beqa. Ndërkohë, fjala për ju zoti ministër, ministri ka të drejtë ta marrë fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet zoti Qerim Bajrami,

Të respektuar deputetë të komuniteteve joshumicë,

Më lejoni që të ju informoj që këtë vit akademik pothuajse bashkë me të gjithë deputetët kemi punuar në kornizën ligjore për përfshirjen e komuniteteve joshumicë në arsimin e lartë.

Shumica prej deputetëve që janë në sallë kanë qenë pjesë e këtij procesi dhe ne e kemi hartuar dhe e kemi miratuar kornizën më të mirë rajonale për përfshirjen e komuniteteve pakicë në arsimin e lartë, sepse në të gjitha konkurset e universiteteve publike që financohen nga buxheti i shtetit kemi paraparë 12% nga komunitetet joshumicë dhe pa dyshim që ky është një hap përpara dhe tregon gatishmërinë e Qeverisë dhe Ministrisë së Arsimit për gjithëpërfshirje.

Dhe, më lejoni të ju njoftoj që pas raportimit që kemi pasur në Komisionin e Komuniteteve, bashkë me rektorin kemi ardhur me shifra të sakta, të cilat rezultojnë se 58% të studentëve që kanë konkurruar nga komunitetet joshumicë janë pranuar. Derisa për studentët shqiptarë kjo përqindje shkon nën 50%, pra kemi bërë një qasje jashtëzakonisht afirmative, sepse raportet

zyrtare tregojnë që kemi studentë në ciklin e parë, kemi studentë të pranuar në ciklin e dytë, madje që është risi - kemi studentë të pranuar edhe në doktoratë, gjë që është jashtëzakonisht pozitive.

Kjo qasje afirmative e tregon gatishmërinë tonë për të treguar politika proaktive ndaj komuniteteve.

Ndërkaq, deputetit Qerim Bajrami ia përkujtoj se me angazhimin e ministrisë dhe angazhimin tim, ne e kemi adaptuar edhe ndryshimin e udhëzimit administrativ për të vazhduar me drejtimet në gjuhën boshnjake dhe në gjuhën turke në Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti” dhe, siç e dini, ato drejtime tani janë hapur, sepse studentët janë pranuar.

Jemi duke punuar edhe me drejtimin e Fakultetit Ekonomik, na duhet që të sigurojmë profesorë adekuatë, profesorë që do të ligjërojnë në gjuhën boshnjake dhe Universiteti i Prishtinës është në kërkim të marrëveshjeve të mirëkuptimit me universitetet e Bosnjës, me universitetin e Tuzllës, me universitetin e Sarajevës, që të kemi sa më shumë profesorë që do të vijnë dhe do të mbajnë lëndë për shkak se janë këto rregulla ligjore.

Unë kam dëgjuar shqetësimet tuaja për pranimin e studentëve në master dhe dje e kam takuar rektorin e Universitetit të Prishtinës, profesor Marian Demën, për t’u siguruar se nëse të gjithë studentët e komuniteteve joshumicë e kanë pasur mundësinë ta japin tekstin në gjuhën e vet amtare dhe ju siguroj se në qoftë se ndonjë studenti i është privuar kjo e drejtë, Ministria nëpërmjet Inspektoratit do të kërkojë që në plotësi të respektohet udhëzimi administrativ dhe secilit t’i mundësohen që testet pranuese, siç ka qenë në ciklin themelor, në të gjitha universitetet të jepen në gjuhën amtare.

Pra, ne po promovojmë standarde jashtëzakonisht të larta, ndoshta edhe për rajonin, për përfshirjen e komuniteteve joshumicë në sistemin arsimor dhe kjo do të jetë një politikë afatgjate që është edhe në frymën e Kushtetutës dhe shtetit tonë për të udhëhequr politika proaktive për gjithëpërfshirje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, në qoftë se ke diçka. Qerim Bajrami, ju lutem!

ĆERIM BAJRAMI: Samo kratko! Vetëm shkurt!

Dakle mi tražimo da se ovo što jeste dobro u administrativnim uputstvima, i još jednom želim da iskoristim priliku na angažmanu koje imao ministar Arsim Bajrami vezano za ova pitanja.

Međutim ono što sam rekao i na Komisiji, ponoviću i ovde. Ministar ne može odraditi sve tehničke detalje vezano za ova pitanja i ove probleme. Ja sam siguran da od vjegovog

administracije na žalost nema dovoljno ljudi vezano za odrađivanja manjinskih pitanja, ali to ju dugoročni problem.

Ovo što mi sada tražimo jeste da naši studenti koji trenutno kandidati dakle za master studije dobijaju pravo fakulteta ovde u Prištini, bude što prije rešeno njihovo pitanje da po administrativnu uputstvu budu primljeni na master studijama.

Drugo, ministre, dobri su ovi vaši kontakti vezani dakle sa Sarajevski univerzitet, Tuzlanski univerzitet i tako dalje, ali to su dugoročni dakle kontakti i dugoročna pitanja.

Vi imate konkretno dakle zadatak koje donela ova Skupština i obavezala vas da otvorite smer na Ekonomskom fakultetu u Prizrenu, izdvojila je 50 hiljade evra, što je više nego mnogo za taj smer do nove godine.

Ne možemo čekati tu saradnju sa Bosnom i sa univerzitetima u Sarajevu i Tuzli oko ovog smera. Mi imamo ovde naše profesore koji mogu da sutra pokrenu taj smer, radi se o vašoj odluci i vašoj dobroj volji i dobroj volji rektora Univerziteta u Prizrenu. Sve drugo je samo odlaganje problema koji odlagate već desetak godina oko ovog pitanja. Hvala!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

2. Koha për pyetje parlamentare

KRYESUESI: Deputetja Blerta Deliu-Kodra, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

BLERTA DELIU-KODRA: Kryesues, ministri nuk është këtu dhe do ta tërheq pyetjen.

KRYESUESI: Deputetja Blerta Deliu-Kodra, pyetje prapë për ministrin Abrashi.

BLERTA DELIU-KODRA: Do ta përcjell për seancën tjetër meqë është prapë pyetje për ministrin dhe shpresoj që në seancën tjetër do të vijë, sepse është aktuale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Abdullah Hoti. Nuk është ministri.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Do të ishte mirë që javën e kaluar, kur i kemi pasur ministrat këtu, t'i përfundonim këto pyetje parlamentare, tani ministrat nuk janë, po i lëmë për seancën tjetër këto dy pyetjet parlamentare, edhe këtë për Abdullah Hotin edhe atë Imet Rrahmanin.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Nuk është deputeti këtu.

Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Lutfi Zharku. Nuk është deputeti.

Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Stavileci. Nuk është ministri, domethënë shtyhet.

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami. Urdhëro!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Sipas Kushtetutës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi, ministri i Arsimit në Qeverinë e Kosovës është përgjegjës për çështjet e arsimit në tërë Kosovën.

Bazuar në Ligjin e komunave për arsim, në Republikën e Kosovës shkollat e mesme në gjuhën shqipe mund të përdorin tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit të Serbisë, pas njoftimit të MASHT-it.

Në rast të kundërshtimit nga MASHT-i, çështjet i dërgohen Komisionit të Pavarur. Tekstet shkollore që kundërshtohen edhe nga ky komision nuk mund të përdoren për mësimdhënie pa vendosur Komisioni i Pavarur.

Komisioni i Pavarur i ka shqyrtuar tekstet shkollore në gjuhën shqipe nga klasa e parë deri në të dymbëdhjetën dhe ka konstatuar se një numër i madh i këtyre teksteve janë në kundërshtim me marrëveshjen dhe paraqesin shkelje të Kushtetutës së Kosovës.

Shembujt në vijim dëshmojnë për konstatimet e lartpërmendura në tekstet e gjeografisë, fëmijët mësojnë se Kosova është krahinë jugore e Serbisë. Në librin e matematikës të klasës së katërt teksti, në territorin e Serbisë të paraqitur në kilometra përfshihet edhe territori i Kosovës. Në librin e klasës së tretë të shkollës së mesme - Kushtetutë dhe të drejtat qytetare, nuk ka asnjë referencë për statusin kushtetues të Kosovës. Për Serbinë thuhet se është një shtet unik me dy krahina, lufta e shqiptarëve për çlirim dhe mbijetesën e tyre në Kosovë për portretizuar si presion drejtuar ndaj popullit serb në Kosovë.

Përkundër konstatimeve të Komisionit, këto tekste pa asnjë pengesë u jepen edhe më tutje në shfrytëzim të nxënësve të komunitetit serb në Kosovë.

Zoti ministër,

Çfarë keni ndërmarrë apo çka keni ndërmend të ndërmerrni që ta pengoni shkeljen e Kushtetutës dhe përhapjen e urrejtjes ndaj shqiptarëve nga nxënësit e komunitetit serbë...?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ministri Bajrami e ka fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar nënkryetar,

I nderuar deputet Kurteshi,

Më lejoni të përgjigjem në pyetjen tuaj,

Ju me të drejtë e cituat Ligjin për arsimin parauniversitar dhe në komuna dhe treguat se në bazë të këtij ligji, i cili buron dhe derivon edhe nga plani gjithëpërfshirës i presidentit Ahtisari ka disa specifika sa u përket kurrikulave dhe sa u përket teksteve për shkollat në gjuhën serbe. Në të vërtetë, në bazë të këtij ligji, shkollat që veprojnë që Kosovë në gjuhën serbe kanë të drejtë të përdorin kurrikulat dhe tekstet e Ministrisë së Arsimit të Serbisë, por ato duhet të vijnë në Ministrinë e Arsimit të Kosovës që të verifikohet dhe të jepet pëlqimi.

Në bazë të ligjit, thjesht thuhet se Ministria e Arsimit nuk aprovon ato tekste atëherë themelohet një Komision i pavarur i cili vlerëson këto tekste dhe Ministria e Arsimit e ka bërë këtë rishikim të të gjitha teksteve dhe kurrikulave dhe ka ardhur në konstatim se ato nuk janë në pajtim me sistemin arsimor të Kosovës. Janë analizuar disa tekste, tekstet e gjeografisë, tekstet e historisë, tekstet e gjuhës, të letërsisë, tekstet e muzikës dhe tekstet tjera, dhe janë dhënë rekomandimet që ato tekste duhet të përmirësohen, si dhe kurrikulat.

Dëshiroj të ju tregoj se Ministria e Arsimit është në koordinim shumë të ngushtë me faktorët ndërkombëtarë, sepse vendimmarrja për këtë çështje i tejkalon kompetencat e Ministrisë së Arsimit, sepse është një çështje që duhet të qaset me vendosmëri, por edhe me përgjegjësi politike, dhe jemi në bashkëpunim të ngushtë me faktorët ndërkombëtarë për ta filluar procesin në integritet të plotë të shkollave serbe brenda sistemit arsimor, duke kërkuar me ngulm që të rishikohen këto tekste në pajtim me gjetjet e komisionit.

Në nivel të Ministrisë së Arsimit është formuar një grup i nivelit të lartë, i cili po e bën analizën e përgjithshme të gjendjes në shkollat serbe dhe kjo analizë do të rezultojë edhe me hapat konkretë dhe me afatet konkrete për t'i përfshirë plotësisht këto shkolla brenda sistemit arsimor të Kosovës, duke i respektuar gjithmonë specifikat që kanë këto shkolla dhe në bazë të Ligjit të Kosovës, të miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Këto ditë kemi filluar të punojmë edhe me komunitetet tjera, përpos komunitetit serb, sepse duhet ta pranojmë, ka edhe komunitete tjera që nuk janë të integruar brenda sistemit arsimor.

Jemi duke punuar edhe me komunitetin goran në komunën e Dragashit, që ata të fillojnë dhe të integrohen.

I nderuar deputet,

Natyrisht, kjo gjendje është e papranueshme, sepse jemi plotësisht të vetëdijshëm se këto tekste përmbajnë edhe gjuhë diskriminuese, pasaktësi, por kjo çështje është edhe një çështje politike dhe është përtej vendimmarrjes së Ministrisë së Arsimit sa i përket veprimit.

Ne mendojmë që represioni nuk është zgjidhje, por zgjidhja është vetëdijesimi i plotë, vendosmëria dhe mbështetja e plotë ndërkombëtare që të fillojë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Kurteshi, a ke pyetje shtesë?

ISMAJL KURTESHI: Po, ministër, ligji taksativisht u ngarkon juve që ta zbatoni atë, nuk e ngarkon as faktorin ndërkombëtar, as nuk thuhet që kjo është çështje politike dhe kërkohet edhe përkrahje e tjera.

Unë besoj që ju e kuptoni që moszbatimi i ligjit do të thotë shkelje e ligjit. Para gjërave që veç i përmenda më lart, po i përmend edhe disa gjëra.

Kuadri mësimor për këto shkolla rekrutohet nga autoritetet serbe, ata nuk i nënshkruajnë kontratat e punës, shkollat me mësim në gjuhën serbe nuk u raportojnë drejtorive komunale, shkollat e mesme profesionale dhe gjimnazet hapen pa kurrfarë kriteri, pa marrë leje nga Ministria e Arsimit, kurse paguhen nga kjo ministri.

Numri i mësimdhënësve dhe punëtorëve teknikë në këto shkolla për kokë nxënësi është shumë më i madh se në shkollat me mësim në gjuhën shqipe. Ka raste kur punëtorët që për arsye të ndryshme largohen nga procesi mësimor, ata paguhen edhe pa punuar për muaj të tërë dhe askush...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar deputet,

Jemi të vetëdijshëm për gjendjen e pavolitshme dhe një situatë jo të kënaqshme sa i përket integritetit.

Ministria e Arsimit është e gatshme që ta prezantojë planin edhe para Kuvendit të Kosovës, por Ministria e Arsimit nuk është një organ i cili do të mbyllë shkolla, nuk është një organ i cili do të veprojë me veprime represive, por ne dëshirojmë të punojmë edhe në planin politik, sepse

integrimi i këtyre shkollave është besoj një interes më i gjerë politik dhe duhet të punojmë edhe me përfaqësuesit politikë të serbëve edhe në Kuvend, edhe në Qeveri, që edhe ata t'u bashkohen këtyre përpjekjeve për përfundimin e këtij procesi.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Shukrije Bytyqi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Para se të filloj ta bëj pyetjen, unë do ta bëj të qartë për opinion se ministri i Arsimit, Arsim Bajrami, gjatë seancës së 4 tetorit erdhi këtu afër meje dhe tha që personin nga i cili ai mendon që ne i marrim të dhënat, megjithëse ne kemi kah i marrim informacionet për krejt shpërdorimet në ministrinë e tij, tha e kam thirrur në zyre.

Unë së pari po e pyes ministrin se në çfarë kohe po jetojmë, kur një person pi kafë me deputetin veç pse është punëtor i ministrisë të thirret në aso farë bisedash informative si në kohën e UDB-së.

Çështja që unë do ta shtroj sot: Është dëshmuar se ministri Arsim Bajrami e ka mbushur ministrinë me familjarë, pa asnjë kriter. Andaj unë do ta pyes ministrin konkretisht, a është konflikt interesi emërimi i stafit politik dhe inspektorëve në komisione për licencimin e institucioneve parashkollore, institucioneve para universitare dhe kolegjeve private?

KRYESUESI: Ministri Bajrami e ka fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuar deputete Bytyqi,

Dëshiroj të ju siguroj që Ministria e Arsimit është në radhën e ministrive që ka më së paku të punësuar me kontratë për vepër dhe asnjë i emëruar politik nuk është në komisionet që ju i përmendët dhe ju lutem t'i azhurnoni këto të dhëna dhe do të bindeni.

Në këtë pyetje jam përgjigjur edhe në Komisionin Parlamentar dhe jeni e lirë për të ardhur dhe për të biseduar për këto çështje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shukrije Bytyqi, a do pyetje shtesë?

SHUKRIJE BYTYQI: Unë ministër këtu i kam me emra dhe mund t'i përmend, e nuk kam marrë përgjigje, domethënë nuk ka komision që ju s'keni të emëruar këshilltar tuaj, unë nuk e di pse thoni kështu?!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Besa Baftija, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryesues!

Përsëritet për të gjithë të pranishmit,

I nderuar ministër,

Nxënësit e shkollës fillore të fshatit Haxhaj të komunës së Gjilanit nuk iu gëzuan fillimit të vitit shkollor, jo për atë se nuk duan të mësojnë, mirëpo arsyeja është ajo se shkolla në të cilën mësojnë ata - objekti - është shumë i dëmtuar dhe paraqet rrezik për jetën e tyre.

Kjo shkollë në këtë fshat është ndërtuar në vitin 1978 me vetëkontribut nga qytetarët e fshatit Haxhaj.

Mirëpo, tërmeti i vitit 2004 e ka dëmtuar jashtëzakonisht shumë këtë shkollë, po ashtu edhe lëkundjet e fundit në shtator të këtij viti e kanë bërë të pamundur mësimin në këtë shkollë. Kushtet në atë shkollë me të vërtetë janë shumë të rënda. Përveç që janë në rrezik për jetën, ata janë edhe rrezik edhe për shëndetin e këtyre nxënësve.

Më 13 shtator të këtij viti, nxënësit e kësaj shkollës, së bashku me prindërit, kanë protestuar para shkollës dhe kanë kërkuar nga ministria, apo edhe nga kryetari i Komunës së Gjilanit që ta kenë një shkollë të re.

Pyetja ime konkrete është: Kur këta nxënës do të kenë shkollë të re në fshatin e tyre? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Bajrami e ka fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuar deputete Baftija,

Faleminderit për pyetjen!

Më lejon të ju informoj që tanimë në Ministrinë e Arsimit ka ardhur kërkesa nga Drejtoria Komunale e Arsimit të Komunës së Gjilanit për këtë shkollë.

Unë gjatë javës së ardhshme do ta vizitoj edhe shkollën, edhe nxënësit, dhe do të ju ftoj edhe juve që të shkojmë së bashku për shkak të kujdesit.

Është një problem për të cilin jemi të njoftuar. Jemi duke planifikuar në vitin e ardhshëm, është problem numri i vogël i nxënësve, por do të gjej mundësi që bashkë me Komunën ta bashkëfinancojmë një shkollë të re për këta nxënës, në mënyrë që t'i sigurojmë kushtet elementare, sepse shkolla është bukur shumë e dëmtuar nga tërmeti.

Gjithashtu ju ftoj si deputete që në debatin për buxhetin ta përkrahni ndërtimin e kësaj shkolle, në mënyrë që kjo shkollë të fillojë vitin e ardhshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputetja Baftija, pyetje shtesë?

BESA BAFTIJA: Faleminderit!

Unë ministër e kam vizituar këtë shkollë, jo tash, por edhe më herët, se jam e asaj ane dhe e kam pa për së afërmi se në çfarë kushte mësojnë këta nxënës.

Kërkesë e këtyre nxënësve ka qenë që premtimet që ua keni dhënë tash e sa vite që të kenë shkollë të re nuk janë përmbushur.

Kjo pyetje është bërë edhe në mandatin e kaluar dhe prapë mandatet po vazhdojnë dhe këta nxënës po mbeten në këtë shkollë, ku me të vërtetë janë të rrezikuar siç thashë, jo vetëm nga shëndeti, por është e rrezikuar edhe jeta e tyre.

Kërkesë e tyre ka qenë që ju ta vizitoni, po bënit mirë që ju po shkoni e ta shihni aty vetë për së afërmi se në çfarë kushtesh mësojnë këta nxënës dhe me siguri që unë si deputete e këtij Parlamenti do të kontribuoj në atë drejtim që jo vetëm nxënësit e kësaj shkolle, por të gjithë nxënësit në Republikën e Kosovës të kenë kushtet, të kenë shkolla të mira dhe të mësojnë ashtu siç duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një herë Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti ministër, viti i ri shkollor ka filluar me vonesë për shkak të vonesës së teksteve shkollore, së paku kështu e keni arsyetuar ju.

Viti i ri shkollor, edhe pse ka filluar me vonesë, prapë ka filluar pa tekste shkollore dhe pa ditar të punës. Në ndërkohë, tekstet shkollore të përdorura vitin e kaluar, e sipas ligjit është dashur të shpërndahen prapë këtë vit, kanë mbetur nëpër depo të shkollave.

Zoti ministër,

Në bazë të cilit ligj, nen ose pikë, keni marrë vendim ta shtyni vitin e ri shkollor nga 1 shtatori në 5 shtator? Pse nuk janë shpërndarë tekstet e përdorura vitin e kaluar shkollor? Kush është fajtor për vonesën e teksteve shkollore dhe ditarëve dhe a keni iniciuar ndërmarrjen e masave administrative apo ligjore ndaj atij ose atyre që janë fajtorë për vonesën e teksteve që kanë shkaktuar dëm të riparueshëm për 260 mijë shkollarët e Kosovës në arsimin parauniversitar?

KRYESUESI: Ministri Arsim Bajrami, urdhëro!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar deputet Kurteshi,

Ju keni marrë përgjigje në këtë pyetje në komision, por është me rëndësi që ta kemi edhe në seancë plenare.

Siç e kemi bërë me kohë me dije për shkollat shqipe, kemi treguar që këtë vit ka pasur një problem me sigurimin e fondeve për tekste, sepse në buxhetin e Ministrisë së Arsimit nuk ka pasur fare fonde dhe është dashur që Qeveria ta japë një garanci me vonesë të konsiderueshme që do të sigurohen fondet dhe si pasojë e kësaj ka pasur një vonesë të furnizimit të teksteve.

Në anën tjetër, siç e dini, sivjet ka përfunduar edhe rishikimi i teksteve, 86 tekste nga klasa e parë deri në klasën e nëntë janë ofruar të rishikuara, të pastruara, dhe ka përfunduar dhe secila shkollë publike dhe private i ka marrë tekstet dhe nuk është bërë ndonjë dëm i pariparueshëm.

Kështu që tekstet janë shpërndarë dhe janë shpërndarë të rishikuara, ndërkohë Ministria e Arsimit e ka punuar koncept-dokumentin e ligjit të ri për tekste mësimore dhe kjo do të jetë një reformë shumë e rëndësishme dhe besoj që Parlamenti shumë shpejt do ta ketë edhe këtë ligj dhe do të diskutojë për këtë çështje.

Sa i përket shtyrjes së vitit shkollor për dy ditë, pra ditën e enjte, por ditën e hënë, disa herë e kemi shpjeguar dhe po e shpjegojmë që vetëm që ditën e hënë, sidomos abetaret, të jenë të shpërndara nëpër shkolla.

Ju siguroj se kjo nuk është bërë për motive politike, po e shfrytëzoj rastin që të gjitha partitë politike t'i ftoj që t'i kursejnë fëmijët nga aktivitetet politike, që të parandalojmë cilindo aktivitet politik të partive politike në shkolla dhe të parandalojmë cilindo keqpërdorim të fëmijëve për qëllime politike, sepse ky do të ishte një dëm i pariparueshëm në edukimin e fëmijëve, në edukimin e fëmijëve si personalitete, si qytetarë të dobishëm dhe në ndikimet politike që po bëhen te ta.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi, urdhëro!

ISMAJL KURTESHI: Ministër, as në komision, dhe as tani nuk u përgjigjët kush është fajtor? A është fajtor kryeministri, a është ministri i Financave, apo jeni ju? Dikush mban faj që tekstet shkollore nuk kanë qenë gati as më 5 e as më 15 shtator. Dy ditë e keni shtyrë vitin shkollor për t'i pasur tekstet shkollore të hënë, po as të hënë e parë e as të dytën nuk ka pasur tekste.

Prandaj, ju lutem, tregoni cili është fajtori? Dhe, nuk është keqpërdorim i fëmijëve nëse ne e paraqesim këtu një neglizhencë të madhe të kësaj Qeverie dhe të kësaj ministrie.

KRYESUESI: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Atëherë nëse kërkon fajtor, fajtor është Ligji për buxhetin e vitit 2016, i cili nuk ka paraparë buxhet të mjaftueshëm, sepse Ligji për buxhetin është ai i cili cakton kufijtë buxhetorë.

Por, i nderuar deputet, ju kam sqaruar edhe në komision dhe ju sqaroj edhe tani: Të gjitha tekstet janë dhënë në dy javët e para dhe absolutisht kemi raporte nga drejtoritë komunale dhe asnjë tekst, që ju thatë që ka qenë i vitit të kaluar dhe që ka mundur të përdoret nuk ka mbetur pa u përdorur. E kemi pasur menaxhimin më të mirë sivjet të shpërndarjes së teksteve mësimore dhe ju do ta keni ndoshta edhe auditimin e performansës së teksteve dhe do të bindeni, sepse edhe kemi bërë kursime substanciale të buxhetit shtetëror dhe menaxhimi ka qenë i përpiktë, sepse ka disa rregulla të reja të menaxhimit që kërkojnë procedura jashtëzakonisht strikte.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zafir Berisha, pyetje për ministren Hykmete Bajrami.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë e kam pasur këtë pyetje edhe në seancën, është një temë dhe një çështje për të cilën bashkërisht me ministren dhe kolegët tjerë deputetë kemi debatuar edhe vitin e kaluar, nëse nuk gaboj, diku në shkurt-mars. Është fjala për matësit elektrikë të markës Kohler, për të cilët me të drejtë kemi ngrehur shqetësimet dhe ministrja në disa raste është pajtuar me deputetë dhe i ka informuar deputetët lidhur me lëshimet që janë bërë në këtë drejtim, deri kur kanë pasuar edhe disa arrestime nga një sektori i ministrisë, veçanërisht Institutit Meteorologjik.

Çështja është se unë përsëri po e kthej këtë temë për shkak se vazhdojnë rreth 25 mijë qytetarë t'i mbajnë këta matës elektrikë nëpër shtëpi, që nënkupton se vazhdon vjedhja sistematike e KEDS-it në raport me qytetarët dhe mendoj se Qeveria e ka obligim ta mbrojë qytetarin, përpos tjerash - vjedhjet që janë bërë pas konstatimeve se këta matës elektrikë janë duke matur më tepër sesa duhet kush i kompenson? Imagjinojeni vetëm një euro në muaj t'u vidhet 25 mijë qytetarëve bëjnë 25 mijë euro dhe vjedhjet mund të jenë shumë shqetësuese dhe dramatike dhe me njëfarë forme në rast se ne qëndrojmë indiferentë dhe nuk ndërhyjmë konform mandatis që e kemi për t'u shërbyer qytetarëve, ne në njëfarë forme po i mbështesim bizneset private, në këtë rast KEDS-in, çka është ndërmarrë në këtë drejtim dhe a pritet diçka konkrete që qytetarët të dëmshpërblehen për këtë vjedhje sistematike që po u bëhet tash e sa vjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministrja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Faleminderit, zoti deputet, për parashtrimin e pyetjes,

Siç e thatë edhe vetë, edhe vitin e kaluar kemi diskutuar, kemi debatuar rreth kësaj çështje, në fakt gjendja nuk ka ndryshuar edhe aq shumë, mirëpo më lejoni edhe njëherë që t'ju informoj që nga fillimi. Agjencia e Metrologjisë, në kuadër të kompetencave të veta ligjore e ka miratuar tipin e njehsorëve ALTH04 të prodhuar nga kompania "Kohler" në vitin 2009. Për shkak të

modifikimeve që kompania i ka bërë këtij tipi dhe ka nxjerrë një tip të ri, tipin ALTTH04-01, atëherë është dashur të bëhet përsëri miratimi i tipit të ri.

Në atë kohë, në nëntor të vitit 2013, Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë ka bërë miratimin e këtij tipi, duke përdorur testet e një versioni më të vjetër, domethënë duke përdorur të njëjtat teste kur ka bërë miratimin e një tipi më të vjetër të vitit 2009. Dhe kështu, në nëntor të vitit 2013 janë shfaqur defekte në punën e një numri të këtyre njehsorëve. Në atë kohë agjencia për t'u njoftuar dhe për të marrë vendimin lidhur me suspendimin e parakohshëm të tipit e ka bërë hulumtimin e rasteve.

Një komision zyrtar në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në kuadër përkatësisht të Agjencisë për Metrologji, ka bërë testimin e 100 njehsorëve në tavolinat testuese dhe të gjitha këto teste kanë rezultuar të mira, kanë rezultuar që këto orë elektrike matin mirë dhe janë në kufi të lejuar të matjeve. Në bazë të këtyre testimeve, mandej drejtori i Agjencisë së Metrologjisë, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, e ka tërhequr suspendimin e tipit dhe ka filluar prapë instalimi i këtyre orëve. Për rastin në fjalë në ndërkohë janë hapur, po flasim gjithmonë për vitin 2013, para se unë të shkoj në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për rastin në fjalë janë hapur hetime edhe është kërkuar nga Agjencia e Metrologjisë suspendimi i sërishëm i miratimit të tipit dhe janë kërkuar teste të plota për miratim të tipit në një laborator të akredituar ndërkombëtarisht.

Rezultatet e testimeve të bëra në laboratorin në Institutin Holandez të Metrologjisë, i cili ka qenë i akredituar për matje elektrike, kanë rezultuar se ka devijime në tre indikatorë, nga 38 indikatorë që maten gjithsej. Agjencia e Metrologjisë, në bazë të këtij raporti mandej, ka konstatuar se ky tip i njehsorëve nuk i plotëson kushtet dhe standardet e parapara dhe më 5 dhjetor 2014 e ka marrë vendimin për ta tërhequr miratimin e tipit. Sipas legjislacionit në fuqi, ju e dini që vendimet e drejtorit mund të ankimohen tek një komision i cili...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdo edhe dy minuta.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Më 12 dhjetor, pas marrjes së mandatit, pasi jam informuar me rastin, kam formuar një komision profesional, me profesorë të Universitetit të Prishtinës për të shqyrtuar ankesën e kompanisë, e cila ka qenë furnitor e njehsorëve elektrikë dhe ka bërë ankesë për suspendimin e tipit.

Në fakt, komisioni ka vendosur që kompania nuk ka të drejtë, por në të njëjtën kohë komisioni ka konstatuar se Agjencia e Metrologjisë e ka aprovuar njehsorin si mjet matës në mënyrë të jashtëligjshme dhe ne përfundimisht e kemi tërhequr miratimin e këtij tipi.

Më 29 prill 2015, ish-drejtori i Agjencisë së Metrologjisë, tashmë i ndjerë, dhe zyrtarja e Metrologjisë për madhësi elektrike janë paraburgosur me urdhër të prokurorit në lidhje me rastin e miratimit të tipit të këtyre prodhuesve. Tani, siç e dini, lënda është në gjykatë dhe ne presim vendimin e gjykatës. Prej tre indikatorëve, tre indikatorë të cilët nuk matin, nuk është konstatuar në mënyrë decisive në fakt vidhet energjia elektrike, mirëpo prej 38 indikatorëve janë tre indikatorë, të cilët nuk matin mirë. Në momentin kur të kemi vendimin përfundimtar të gjyqit, nëse konstatohet edhe nga gjykata dhe ekspertizat që këta njehsorë nuk matin mirë, atëherë vendimi do të merret për tërheqjen e këtyre njehsorëve dhe gjithashtu institucionet përkatëse, qoftë ministria ose KEDS-i, do t'i kompensojnë të gjithë konsumatorët, të cilët me vite kanë pasur këta njehsorë elektrike për matës të energjisë elektrike.

KRYESUESI: Faleminderit! Zafiri e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Sigurisht ke konsideratë se më shumë se një minutë besoj se kam për të sqaruar. Jo rastësisht, ministre, unë konkretisht kam pas kërkuar që Instituti i Metrologjisë si agjenci të mos jetë në kuadër të ministrisë, sepse përbën konflikt të interesit dhe koha po tregon, edhe në bazë të deklaratave tuaja, domethënë po vërtetohet ajo sepse është një institut i rëndësisë së veçantë dhe unë kam kërkuar ose t'i japë llogari Qeverisë, ose Parlamentit.

Mendoj se e njoh këtë fushë, sepse flitet për një institucion të rëndësisë së veçantë, i cili ka qenë me seli në Prizren dhe jo rastësisht është sjellë në Prishtinë dhe është fut nën kthetrat e ministrisë për të ndodhë kjo që po ndodh. Por, kjo nuk ka të bëjë vetëm me matësit e energjisë elektrike, por me të gjithë matësit e tjerë, domethënë që kontrollohen nga Instituti i Metrologjisë. Problemi është se ju, ministre, po më vjen mirë që e pranuat megjithatë që qytetarët vidhen, vazhdojnë të vidhen, kanë pasur konstatime, ka pasur tendenca të ekspertëve të Institutit të Metrologjisë të ndryshohet, është konstatuar nga një institut ndërkombëtar, domethënë janë marrë masa, çdo gjë është ok, por po dua të them që ne nuk e përcaktojmë, nuk jemi Zot që ta përcaktojmë fatin e njerëzve kur vdesin, por ne jemi ligjvënës që përcaktojmë fatin e njerëzve të korrumpuar kur duhet të shkojnë në burg.

Unë në seancën e kaluar i kam pas thënë ministrit Hyseni për këto farë targat me letra, a po dyshon si unë edhe ti që janë duke i vjedhur, këtu është në pyetje mafia, ky thoshte jo. Dje kanë filluar hetimet Prokuroria e Shtetit edhe në këtë drejtim. Unë po mendoj që duke u arrestuar keqbërësit, domethënë ngrihet përgjegjësia edhe e institucioneve, edhe e njerëzve të caktuar në institucione. Faleminderit!

KRYESUESI: Këtu pyetje s'ka. Pesë minuta i ke harxhuar ti, edhe ai të vetat, nëse do, insiston, por pyetje s'ke. Veç edhe deputetët, edhe ministrat e dini, ka mundësi interpelancë të bëhet për

këto probleme, kjo është pyetje–përgjigje. Ju lutem, shumë! Të dytë e keni harxhuar kohën, nëse patjetër, një minutë, por të lutem, mos shpjegoni.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: I nderuar, zoti deputet!

Të gjithë zyrtarët, të cilët kanë qenë të involvuar në procesin, në momentin kur janë hapur hetimet, ata janë suspenduar.

Thashë edhe njëherë, rasti është në gjykatë, edhe unë besoj edhe më shumë se ju jam e interesuar që të gjithë keqbërësit, njerëzit e korruptuar dhe mafia të shkojnë në burg dhe të shkojnë atje ku e kanë vendin. Sa i përket tërheqjes së Agjencisë së Metrologjisë për t'i raportuar qoftë Kuvendit, qoftë Qeverisë, kur doni bëjeni një propozim të tillë, asnjë interes si ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nuk e kam që ta kem këtë agjenci nën ombrellën e kësaj agjencie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë urdhëro, ministri Hyseni, sepse e ka apostrofuar.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues,

I nderuar deputet Berisha,

Prokuroria është absolutisht e mirëseardhur të hetojë çfarëdo pretendimi që mund të bëhet qoftë publikisht, qoftë në kanalet e tjera. Kështu që mos e keqpërdor foltoren, ishe duke i bërë pyetje një ministre tjetër dhe u hodhe në tema të tjera.

Prandaj, dola të jap përgjigje që ne vetë kemi kërkuar që të hetohet dhe të shihet pse ka ngecur ky proces. Janë procedurat e tenderimit fatkeqësisht shumë të komplikuar dhe unë e mirëpres dhe, po e them këtu publikisht edhe njëherë, e mirëpres fuqimisht hetimin dhe trajtimin e çfarëdo pretendimi që ka të bëjë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, në të vërtetë që ka të bëjë me çfarëdo ministrie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Skënder Hyseni.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër, Kosova ka një ligj për të huaj, ka informacione kështu joformale nga terreni që në Kosovë punon një numër i caktuar i punonjësve nga vendet e ndryshme. Natyrisht që kjo do të ishte shumë e mirë, sikur zhvillimi ekonomik të ishte në atë nivel që ne të kemi nevojë për punëtorë të huaj, për shembull, sikur të ishin realizuar premtimet elektorale të partisë tuaj dhe të partnerit tuaj, por kjo s'ka ndodhur.

Prandaj, pyetja ime është sa është numri i punonjësve në Kosovë që vijnë nga vendet e tjera dhe prej cilave vendeve vijnë ata?

KRYESUESI: Ministri Hyseni e ka fjalën.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Topalli,

Pyetja juaj është shumë koncize, shumë e saktë. Unë jam i gatshëm edhe në komente të përgjigjem, por përgjigjem në pyetjen tuaj që është shumë e saktë, në rend të parë.

Pra, Kosova ka një ligj për të huaj dhe në pajtim me normat e këtij Ligji për të huajt, aktualisht dhe sipas shënimeve të fundit të Departamentit për Azil, Shtetësi dhe Migrim, në Kosovë janë të regjistruar 2991 shtetas të huaj. Po e përsëris, 2 991. Prej tyre, me qëllim të punësimit dhe me leje pune janë të pajisur 1378. Nëse pyetja juaj rastësisht implikon ose nënkupton edhe numrin e kompanive të huaja që ushtrojnë aktivitet ekonomik në Kosovë, atëherë këtë pyetje duhet t'ia shtroni Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, sepse është kjo ministri që e bën licencimin e kompanive.

Ata të punësuar në Kosovë vijnë kryesisht nga Turqia, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe një numër po ashtu nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Zoti Topalli, a ke pyetje shtesë?

FATON TOPALLI: Po, do të doja të dija edhe në cilat sektorë punojnë ata punonjës që vijnë nga vendet e ndryshme dhe sa është numri i atyre që vijnë nga Turqia që punojnë në Kosovë, sepse kjo sigurisht ka të bëjë, besoj, edhe me aeroportin apo me KEDS-in.

KRYESUESI: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Me kënaqësi do të jepja shifra të tilla, zoti deputet Topalli, por ju nuk i keni kërkuar këto specifikime. Unë ju siguroj që do t'ua dërgoj me shkrim çdo përgjigje në secilën nënpyetje, por ju që e keni dërguar te unë nuk keni kërkuar asnjë lloj specifikimi të kësaj natyre.

Keni kërkuar sa është numri i përgjithshëm i të punësuarve në Kosovë nga shtetet e huaja dhe nga cilat vende vijnë këta.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin LutfiZharku.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Po vazhdoj shkurtimisht me ministrin e Punëve të Brendshme, pyetjet shitesë i kemi për shkak që duhet të sqarohen çështjet që i tha ministri. Prandaj, kjo ishte pyetje shitesë dhe pyetjet shitesë nuk mund t’ia dërgoj paraprakisht.

Tash, po vazhdoj me pyetjen për ministrin tjetër, gjithashtu nga informacioni në terren kemi kuptuar se një numër i punonjësve vijnë nga Rumania, gjë që ministri i Punëve të Brendshme nuk e tha...

KRYESUESI: Pyetje ke për Zharkun, o zotëri!

FATON TOPALLI: Po, po, këtë jam duke e bërë.

KRYESUESI: Po, bëjani Zharkut pyetjen, jo këtij.

FATON TOPALLI: Nëse më lejoni të flas...

KRYESUESI: Po, rregullat ekzistojnë.

FATON TOPALLI: Po, pyetja ime lidhet me të dy, prandaj janë edhe dy ministrat këtu. Edhe njëherë, zoti Zharku, një numër i punonjësve nga Rumania, të cilët nuk i përmendi fare zoti ministër Hyseni, prandaj edhe ju kam ftuar dyve për t’i shtruar këto pyetje, punojnë në ndërmarrjen “Bechtel Enka”, edhe janë punonjës kryesisht që punojnë në sektorë që mbulojnë punëtorët tanë, prandaj pyetja ime për ju është ashtu edhe siç e kam formuluar: sa është numri i punëtorëve që vijnë nga Rumania? Pse punojnë ata këtu? A ka ndonjë marrëveshje me “Bechtel Enkën” për këtë çështje?

Ka gjithashtu informacione që nga numri që vijnë, i punëtorëve nga Rumania, punëtorët që punojnë në “Bechtel Enka” frikësohen se do të largohen nga puna, bile-bile edhe flasin që ka plane për t’i larguar.

KRYESUESI: Ministri Zharku e ka fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Topalli,

Do të përgjigjem vetëm në pjesën ashtu qysh e kam të shkruar, e që ka të bëjë me numrin e punonjësve të huaj që punojnë në “Bechtel Enka”. Më 2 korrik 2014 është nënshkruar kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe kompanisë fituese “Bechtel Enka” për ndërtimin e autostradës “Arbër Xhaferi” nga Prishtina deri në Han të Elezit. Kushtet e kontratës nuk

përcaktojnë asnjë kushtëzim sa i përket punësimit qoftë vendor apo ndërkombëtar dhe kontraktori “BechtelEnka” ka të drejtë të përzgjedhë punëtorët për implementimin e projektit, megjithatë me një përkushtim për punësim, për dhënie të përparësisë të punëtorëve vendës.

Duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, konsorciumi “Bechtel Enka”, si korporatë ndërkombëtare, ka sjellë në Kosovë ekskluzivisht personelin e nevojshëm profesional për ndërtimin e projektit të përmasave tilla, e që nuk mund të gjenden në vendin tonë. Përkushtimi i tyre i plotë është zbatimi i projektit në angazhim maksimal të mundshëm të fuqisë punëtore vendëse.

Aktualisht, numri i përgjithshëm i punëtorëve të angazhuar në projektin e ndërtimit të autostradës është 2 mijë e 086, nga të cilët 77,5%, gjegjësisht 1 mijë e 616 janë punëtorë vendës e që tregojnë përkushtimin e plotë të kontraktorit për angazhim të fuqisë punëtore vendëse.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Po, faleminderit! Jam i tmerruar nga kjo që në një kontratë e cila do të duhej të sigurote vende të reja të punës, zhvillim, ai që ka bërë kontratën, pra Qeveria, nuk ka bërë asnjë kushtëzim sa i përket numrit të punëtorëve, domethënë “Bechtel Enka” dhe cilado ndërmarrje tjetër, po në rastin konkret “Bechtel Enka” mund të sjellë sa të dojë, mund t’i sjellë edhe 2086 punëtorë nga jashtë në kohën kur kemi një papunësi jashtëzakonisht të madhe në Kosovë.

Ju nuk u përgjigjet fare në pyetjen time, sepse pyetja ime është shumë konkrete: sa është numri i punonjësve që vijnë nga Rumania, një, e dyta ata në bazë të informacioneve që kam, nga kampi Bondstillit, rreth Sojevës, ata punojnë kryesisht kamionxhinj, bageristë, punë që i bëjnë që kemi mjaft punëtorë këtu në Kosovë. Urdhëroni dhe përgjigjuni në pyetjen që shtrova.

KRYESUESI: Lutfi Zharku e ka fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Deputet, më vjen keq, po kjo është çështje e Inspektoratit të Punës, nuk është në domenin tim.

KRYESUESI: Ministri Hyseni e ka kërkuar fjalën, një minutë.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: I nderuar deputet Topalli!

Ju sërish bartni aluzion krejtësisht të pavend, sepse nuk është Ministria e Punëve të Brendshme ajo që ia imponon ose përcakton një kompanie të huaj që ka marrë punë në Kosovë çfarë punëtorësh do të ketë.

Unë fola, u përgjigja në pyetjen tuaj, nga vijnë të punësuarit nga jashtë, kryesisht dhe thashë kryesisht. Nuk mund ta specifikoj se ndoshta ka nga të gjitha 193-194 vende anëtare të OKB-së ndonjë punëtor në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit! Mirë e ke, ta ka përmendur emrin, një minutë.

FATON TOPALLI: E para, thatë që pyetja ime është shumë konkrete. Unë ju kam pyetur nga cilat vende vijnë ata dhe ju m'i numëruat vendet prej të cilat vijnë ata. Nuk e përmendët në asnjë vend numrin e punonjësve nga Rumania. Pra, domethënë që e dini, por nuk dëshironi ta përmendni, ose ata punonjës janë duke punuar ilegalisht në Kosovë.

Nëse janë duke punuar ilegalisht në Kosovë, duhet të ndërmerrni masa t'i identifikoni dhe t'i trajtoni sipas Ligjit të punës dhe sipas Ligjit për të huaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë Aida Dërguti, pyetje për ministrin Hyseni. Aida po e shoh që s'është këtu. Mytaher Haskuka, pyetje për ministrin Zharku.

MYTAHER HASKUKA: Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Autostrada "Ibrahim Rugova" është njëra ndër më të shtrenjtat në Evropë dhe sot e kësaj dite nuk është deklaruar zyrtarisht vlera e shpenzuar e buxhetit të shtetit në kontraktimin e "Bechtel Enkës". Edhe pse shtrenjtë, kualiteti i saj mbetet për të dëshiruar edhe në shumë vende kjo autostradë nuk lidhet me vendbanime në mënyrë të drejtpërdrejtë, por tërthorazi.

Për shembull, edhe pse autostrada kalon shumë afër Prizrenit, qyteti nuk është i lidhur drejtpërdrejt me autostradën, por lidhja shkon në rrugë të stërzgjatura, transite, ku nga qendra e Prizrenit lidhja më e afërt me autostradën është minimum 11km. Pos këtyre lidhjeve të pakuptimta, autostrada në shumë vende ka ndërprerë rrugët e vjetra dhe nuk janë ndërtuar ura lidhëse nëpër nënkalime, në vendet ku kanë qenë rrugët e vjetra.

Si shembull është edhe fshati Zhur. Në këtë fshat autostrada ka ndërprerë fshatin nga tokat bujqësore, mbi 500 hektarë të tokës bujqësore në zonat blegtorale janë ndarë nga fshati dhe nuk është ndërtuar as urë e as nënkalim për fermerët dhe banorët e kësaj zone. Konkretisht në vendin e quajtur "Gomni" autostrada ka bllokuar rrugën e vjetër të fshatit dhe zhurjanët janë të penguar nga qasja e drejtpërdrejtë në tokat e tyre bujqësore.

Pyetja ime lidhur me këtë është: a ka plan Qeveria, e në veçanti Ministria e Infrastrukturës, t'i rregullojë këto padrejtësi që u janë shkaktuar qytetarëve në qasje ndaj pronës së tyre private me ndërtimin e autostradës, në veçanti pse nuk është realizuar projekti i urës, si dhe mbikalimit, e

cila ka qenë e premtuar gjatë ndërtimit të autostradës dhe e cila do të lidhte fshatarët e Zhurit me tokat e tyre bujqësore në këtë zonë? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Zharku e ka fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

I nderuar deputet Haskuka,

Ministria e Infrastrukturës ka realizuar projektin e ndërtimit të autostradës “Ibrahim Rugova”, kurse punimet janë ekzekutuar nga kontraktori “Bechtel Enka” që janë përfunduar në fund të vitit 2013. Realizimi i punimeve është bërë konform projektit kryesor të ndërtimit të autostradës, i cili është punuar sipas standardeve TEM, sistem i mbyllur me shpejtësi maksimale projektuese 120-140 km/h.

Nga faza e projektimit të trasesë autostradës dhe gjatë projektimit të nënkalimeve, mbikalimeve dhe rrugëve anësore janë marrë parasysh nevojat dhe kërkesat e banorëve për sigurimin e vazhdimësisë së lidhjeve ekzistuese dhe në disa pjesë edhe përmirësimin e tyre. Gjatë të gjitha aktiviteteve në projektin e ndërtimit të autostradës është bashkëpunuar ngushtë me kuvendet komunale, me përfaqësuesit e banorëve të fshatrave rreth autostradës, përfshirë ata të Zhurit dhe askund nuk janë lënë pjesë të tokave bujqësore të bllokuara si pasojë e ndërtimit të autostradës.

Në lokacionin e Zhurit, nga kilometri i 7-të deri në kilometrin e 9-të të segmentit të parë të autostradës është ndërtuar mbikalimi dhe rrugët anësore me gjatësi prej 4 km, kurse përgjatë rrethojës së autostradës janë lënë 3 deri 4 metra për nevoja të qasjes në pronat bujqësore. Konkretisht në vendin ku ju e përmendët, në mes të Dobrushës dhe Vlashës, është ura që përdoret nga të gjithë banorët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Faleminderit për informatat, ministër!

Po unë para dy jave isha në Zhur dhe faktikisht, edhe kryetari i Bashkësisë Lokale të Zhurit, por edhe fshatarët e tjerë më informuan si, për shembull, në rrugën që është quajtur “Gomni” është ndarë nga autostrada dhe nuk ka kalim aty, ajo është si të thuash lidhja kryesore e tyre me tokat bujqësore.

Prandaj, në mënyrë tërthorazi duhet të shkojnë në toka. Jui treguat edhe vendet e tjera lidhëse, por ndoshta edhe atyre duhet t’iu tregojmë atje se ku duhet të lidhen, se shumë nga fshatarët thoshin që për të shkuar te tokat e tyre duhet të udhëtojnë me kilometra të tëra, edhe pse e kanë shumë afër.

Domethënë, unë ju kisha propozuar që ta bëni një vetëdijesim atje në fshat, ndoshta t' u shpjegohet atyre se kah të shkojnë te tokat e tyre bujqësore.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë për ta bërë kohën edhe më efikase edhe të dobishme, unë mendoj që të vazhdojmë me pyetjet që u drejtohen ministrave që janë këtu.

Deputeti Ali Berisha, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

ALI BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Një problem i madh për banorët e Dukagjinit është rruga Pejë-Prishtinë, gjegjësisht aksi rrugor Llozicë-Pejë. Dinamikat e ndërtimit të asaj rruge janë jashtëzakonisht të ngadalshme, është bërë problem sidomos në këtë kohë qarkullimi në atë rrugë.

Gjithashtu, ndërtimi i asaj rruge zakonisht po fillon në kohë vjeshte, ku për gjashtë muaj gjatë dimrit gjithë ata që kalojnë atë rrugë është një makth i madh. Zoti ministër, çka po ndodh në atë ndërtim dhe pse janë këto dinamika kaq të ngadalshme?

KRYESUESI: Ministri Zharku e ka fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Berisha,

Rruga magjistrale Prishtinë-Pejë aktualisht po punohen në dy segmente, në pjesën Gjurgjicë-Kijevë dhe Zahaç-Pejë.

Në përgjithësi, vështirësitë në përfundimin e punimeve shkaktohen nga projektimi jo i duhur, apo të mos themi joprofesional që është mungesë serioze, besoj, në shumicën e projekteve kapitale të cilido institucion, e besoj që ju jeni përballur me të gjatë kohës sa keni qenë kryetar, si dhe problemet e shpronësimit.

Natyrisht, këto probleme për shkak të natyrës delikate shpesh përcillen edhe me dobësi menaxheriale, por edhe me arsyetim të kontraktorëve për zgjatjen e punimeve. Sa i përket segmentit Gjurgjicë-Kijevë që nga fillimi jemi përballur me probleme të shpronësimit, të cilat fatmirësisht vitin e kaluar janë zgjidhur dhe sivjet është funksionalizuar pothuajse i tërë segmenti. Punët aktuale që po kryhen kanë të bëjnë me punë të paparapara në projektin fillestar, siç është ndërtimi i mureve mbrojtëse dhe zgjerimi i mbikalimit në Belincë, kurse ndërtimi i urës në Llozicë është pasojë e papërgjegjesisë së kontraktorit të mëparshëm.

Në varësi të kushteve atmosferike, ne presim që deri në fund të vitit të lëshohet në qarkullim i tërë segmenti deri në Kijevë. Sa i përket segmentit Zahaç-Pejë, problemet janë shkaktuar për shkak të mosharmonizimit të projektit fillestar me planin urbanistik të Komunës së Pejës, si dhe shpronësimeve të mëdha që kanë qenë të parapara.

Gjatë vitit të kaluar është punuar në harmonizimin me Komunën e Pejës, në revidimin e projektit që t'u iket shpronësimeve të mëdha, të cilat jo vetëm që do të shkaktinin kosto të panevojshme financiare për buxhetin e Kosovës, por do të shkaktinin edhe çrregullim të jetës së banorëve dhe bizneseve në atë segment.

Siç e dini, sivjet ka filluar puna me kapacitete të shtuara, nga të gjitha kompanitë. Ne presim që t'i zgjidhim edhe disa probleme pronësore me banorët e asaj ane dhe me Infra Kosin, në mënyrë që vitin e ardhshëm të kryhet i tërë segmenti. Në fund, më lejoni t'ju njoftoj që për pjesën e mbetur Kijevë-Zahaç është punuar studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social, kurse marrëveshja për financimin e saj do të nënshkruhet me Bankën Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim dhe Bankën e Investimeve Evropiane, në pjesën e parë të vitit të ardhshëm që t'i hapet rrugë fillimit të punimeve për atë pjesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputet Ali Berisha, a e do fjalën?

ALI BERISHA: Zoti ministër, konkretisht nuk dëgjuam diçka për afate. A janë ndarjet buxhetore për atë rrugë në vite të caktuara dhe kur do ta kemi atë rrugë të përfunduar?

Unë e di që aspektet teknike rregullohen para se të fillohen projektet, dhe pse pjesë nga buxheti të asaj rruge shpeshherë po hiqen nga ai projekt dhe po delegohen në projekte të tjera, siç ka ndodhur në vitin 2014. Besoj që ai projekt dhe ajo rrugë është në shfrytëzim të 1/3 të popullatës së Kosovës, ajo rrugë sa më shpejt duhet të jetë në funksion të qytetarëve.

KRYESUESI: Ministri Zharku e ka fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Deputet, besoj se sa i përket afateve, isha i qartë që në përputhje me planin, vitin e ardhshëm kryhet krejt. Domethënë, pjesa që po flasim Kijevë-Zahaç, në realitet Zahaç-Pejë dhe pjesa deri në Kijevë, Gjurgjicë – Kijevë, në përputhje me, natyrisht ne nuk mund ta rregullojmë motin, është çështje e motit, ne jemi në përfundim e sipër të atyre punëve.

2014 nuk e di, por 2015, 2016 asnjë cent s'u bart prej atyre projekteve në projektet e tjera.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Rexhep Selimi, pyetje për ministrin Skënder Hyseni.

REXHEP SELIMI: Faleminderit! Ndonëse kjo pyetje është bartur nga seanca në seancë për shkak të volumit të pyetjeve parlamentare, prapëseprapë për fat të keq nuk e ka humbur aktualitetin dhe unë po vazhdoj ta bëj të njëjtën pyetje.

Në prill të vitit 2009, në Dhomën e Dëshmime në ndërtesën e Drejtorisë së Policisë së Kosovës gjatë kohës kur ka qenë ministër Zenun Pajaziti u evidentua se rezultonin të vjedhura mbi 47 kg drogë, të tipit heroinë. Mbi 3 milionë euro të valutave të ndryshme, armë, dëshmi dhe shumë sende të tjera me vlerë. Atë botë u la përshtypje se problem ishte tek kalimi i kompetencave nga UNMIK-u te zyrtarët e Policisë së Kosovës përgjatë muajve shkurt, prill dhe maj.

Edhe pse zyrtarisht drejtori i Policisë së Kosovës, atëherë Sheremet Ahmeti, nuk e dha këtë version, por me kalimin e kohës u kuptua qartë se autoritetet e Kosovës nuk kanë qenë të interesuara për ta ndjekur çështjen. Përveç një arrestimi gjatë qershorit të vitit 2009, nuk u dëgjua më për këtë çështje. Sikur të mos mjaftonte kjo ngjarje tepër e rëndë, ndodhi edhe në vitin 2012, teksa drejtor i Policisë ishte Shpend Maxhuni dhe ministër Bajram Rexhepi.

Sërish në Dhomën e Dëshmime në Ndërtesën e Policisë së Kosovës në Pejë kur u shpallën të vjedhura 25 kg ari të konfiskuar më herët. Pyetja ime, zoti ministër, është kjo: nga këto skandale që kanë përcjellë Policinë e Kosovës kemi pasur deklarata se këto raste janë drejt zbulimit dhe arrestimit të autorëve, a mund të na thoni deri ku keni arritur me hetimin për rastet e vjedhjes në Dhomat e Dëshmime të Policisë së Kosovës?

KRYESUESI: Ministri Hyseni e ka fjalën.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: I nderuar deputet Selimi,

Të nderuar deputetë,

Mund të ketë pasur deklarime që këto raste janë drejt ose afër zbulimit, ju siguroj që unë nuk e kam bërë një deklaram të tillë asnjëherë, prandaj e kam vështirë pak t'iu referohem në mënyrë specifike deklaramëve. Mirëpo, unë do të jap përgjigjen në të dyja pyetjet.

Sa i përket vjedhjes së dëshmime në Dhomën e Dëshmime, sepse droga për të cilën flasim, në momentin që është sekuestruar është dëshmi, më nuk do t'iu referohemi ashtu. Më datën 02.09.2009 ky rast ka kaluar në kompetencë të EULEX-it. Sido që të jetë, pikërisht mbështetur në arrestimet, në një arrestim që ju e përmendët, Policia e Kosovës më ka raportuar se janë duke e vëzhguar këtë situatë dhe në momentin që do të paraqiten prova të reja, patjetër që Policia e Kosovës dhe Prokuroria duhet të merren edhe me këtë rast, pavarësisht që i ka kaluar EULEX-it si lëndë, e që për shkak si duket të afateve ligjore, për fat të keq është vjetruar.

Ndërkaq, sa i përket vjedhjes në Dhomën e Dëshmive në Pejë, Inspektorati Policor i Kosovës, në bashkëpunim me Prokurorinë Speciale ka ndërmarrë veprime hetimore, me ç'rast është ngritur kallëzim penal dhe për të cilin janë zhvilluar procedura në prokurori, përkatësisht gjykatë.

Gjithashtu, lidhur me këtë rast janë paraqitur prova të reja, për të cilat Inspektorati Policor i Kosovës është duke ndërmarrë veprime hetimore në koordinim me prokurorin special të Kosovës dhe rasti është në progres.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Në shërbim të qartësimit sa më të madh, do të kisha bërë edhe pyetje shtesë. Ju thatë që tashmë është futur, se ka prova të reja, normalisht që ju po i referoheni si dëshmi vjedhjes në Dhomat e Dëshmive në të dyja rastet, por po harrojmë se sikur kjo dëshmi të mos ishte ari, sikur kjo dëshmi të mos ishte para, sikur kjo dëshmi të mos ishte drogë, nuk do të vidheshin, normalisht.

Por, sidoqoftë prapëseprapë për të qenë korrekt me detyrën tuaj po e pranoj thjesht që është dëshmi. Por, në të njëjtën kohë ne kemi pasur një gatishmëri ekstreme të zyrtarëve të Policisë së Kosovës për të dalë në konferenca shtypi, për të shpjeguar rrjedhën gjatë arrestimit të aktivistëve të “Vetëvendosjes” dhe akoma nuk kemi parë një gatishmëri të tillë nga Policia e Kosovës, të cilin ju e keni nën domenin e udhëheqjes, të kenë dalë dhe ta kenë sqaruar qytetarin se deri ku kanë arritur këtu.

Sidoqoftë, unë dua ta them edhe njëherë, ose duhet të bëj pyetje shtesë, meqë ju keni rifilluar ose...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: A bën pyetjen, mos komento! Selim, një minutë!

REXHEP SELIMI: Fillova pyetjen, e cila nuk është e gjatë. Meqë ju thatë që veç ka rinisur si të thuash kjo, kur mund t'i shohim shpejt ju dhe Policinë e Kosovës në një konferencë shtypi që ju do t'i nxirrni së paku rezultatet e para që qojnë drejt arrestimit të autorëve të këtyre vjedhjeve?

KRYESUESI: Urdhëro, ministër, edhe ti mund ta zgjatësh fjalimin nëse ke nevojë.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Shumë i nderuar deputet Rexhep Selimi!

Të siguroj që as që kam qenë në dijeni, as që duhet të jem në dijeni kur Policia e Kosovës organizon konferenca për media.

Unë po të them, të siguroj është çështje krejtësisht jotja beson ti, s'beson dhe prandaj, përgjigjja është nuk e di nëse Policia e Kosovës, sepse Policia e Kosovës vendos nëse duhet të mbajë konferencë për diçka apo jo. Policia e Kosovës vendos për mënyrat e komunikimit me publikun dhe absolutisht për aq kohë sa do të jem ministër i Brendshëm nuk do të ngatërrohem në kompetenca dhe veprimet profesionale të Policisë së Kosovës, qofshin ato në raport me media, qofshin ato në raport me hetimet e çfarëdo rasti të mundshëm, përfshirë edhe rastin e aktivistëve të arrestuar të "Vetëvendosjes".

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, fjalën e kërkon deputetja Kadaç-Bujupi që ka pyetje për ministrin Blerand Stavileci.

DONIKA KADAÇ-BUJUPI: Faleminderit!

Para se të kaloj te pyetja, desha edhe njëherë të tregoj që ky vend më fare s'po funksionon.

Para 10 minutave kryetari i Kuvendit pasi e dha një urdhër kështu direkt për një prokuror, e mori në pyetje një deputete, e lëshoi seancën dhe shkoi të bëjë fushatë në Arbanas. Pas asaj është hera e dytë që kërkojmë nga ministrat dhe kryeministri që të jenë këtu dhe të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre, po ata çdoherë mungojnë dhe pyetja ime ishte pikërisht në këtë drejtim, për përgjegjësinë dhe llogaridhënien për vendimin e padrejtë, i cili i kushtoi shumë Kosovës, por edhe qindra punëtorëve.

Bëhet fjalë për vitin 2012, kontrata për shitjen e Distribucionit të KEK-ut, e cila u realizua për 26,3 milionë euro. Atë kohë u premtua se do të investohen rreth 300 milionë euro dhe se nuk do të ketë largim të punëtorëve. Ky premtim u pat bërë nga ish-ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj dhe ish-kryeministri Hashim Thaçi, tash i ashtuquajtur president i Kosovës dhe jo që nuk u investuan 300 milionë, por realisht brenda këtyre viteve u larguan nga puna 300 punëtorë, të cilët kishin kontrata të përhershme.

Dhe, pyetja ime ishte pikërisht të thërrasim në përgjegjësi ata të cilët morën këtë vendim dhe të japin llogari ata të cilët sot po promovojnë projektet e tilla. Mirëpo, meqë ata nuk janë këtu, unë pyetjen time do ta bart për seancën e radhës dhe të radhës dhe të radhës, derisa ata të vijnë dhe të na njoftojnë se çfarë do të ndodhë me fatin e 300 punëtorëve dhe rrjedhimisht kush do të japë llogari për shkelje të vazhdueshme të Ligjit të punës dhe të ligjeve të tjera në këtë vend.

E sa për kryetarin e Kuvendit, nëse s'mundet të qëndrojë në seancë, por dëshiron të shkojë në fushatë, atëherë ose po shkojmë në zgjedhje të gjithë, ose po e ndërrojmë kryetarin e Kuvendit, se kështu s'funksionon...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Atëherë, deputetja e fundit që bën pyetje, sepse koha një orë kaloi, është Teuta Haxhiu që ka pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Së pari po ju them që ju po e shkelni nenin 45 të Rregullores së Punës së Kuvendit. Është mirë që ta respektoni edhe ju si nënkryetar, edhe kryetari i Kuvendit, që të dy po e shkelni në mënyrën tuaj.

Ju duke i cenuar të drejtën për të parashtruar pyetjet deputeti edhe në momentin kur nuk është përfaqësuesi i Qeverisë, nuk është risi pse nuk janë ministrat. Ju po angazhoheni për të punuar për ministrat, në mënyrë që të mos humbin kohë këta çohen. Në fakt, këta nuk janë duke punuar, kështu që mos u preokuponi për ta prishur edhe radhitjen e pyetjeve, sepse pyetjet duhet të lexohen dhe kanë të drejtë deputetët për ta bërë.

Pyetja ime për kryeministrin ka të bëjë pikërisht me çështjen e mosrespektimit të rezolutave, të dokumenteve të nxirren nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Andaj, kam të drejtë që ta kërkoj për në seancën e radhës.

KRYESUESI: Duke mbaruar këtë orë, unë u them të gjithë atyre që nuk duan racionalitet në punë, që asnjëherë nuk e kam kaluar rendin. Kam regjistra, e keni gabim. Unë kam thënë bëjini efikase pyetjet, njerëzit që janë këtu të përgjigjen, por nuk kam kaluar radhë, mund të vini ta merrni.

Kështu që gabim e keni, edhe kjo pikë e rendit të ditës që i thonë pa rend dite, pyetje parlamentare, u krye. Ju informoj që pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit.

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Në sallë janë 73 deputetë, më duket njëri doli, 72 janë. Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 29 shtator 2016?

Nuk shoh vërejtje, konsideroj që Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 29 shtator 2016.

4. Votimi për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se votimi i deputetëve në seancë plenare sipas aktgjykimit së Gjykatës Kushtetuese, datë 12 prill 2013, bazuar në pikën 141 të aktgjykimit deputeti konsiderohet se është duke marrë pjesë në seancë nëse merr pjesë në votim, duke u deklaruar qoftë për, qoftë kundër, qoftë abstenim.

Nëse deputeti nuk merr pjesë në votim, konsiderohet se nuk ka marrë pjesë në seancë plenare.

Ju njoftoj se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 22 shtator 2016, andaj sot vazhdojmë me votimin e rekomandimit të Komisionit për emërimin e zotit Avdullah Aliu anëtar në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Ju lutem, edhe regjisë, edhe deputetëve, të bëhen gati për votim. Në sallë janë 71 deputetë, votojmë tash!

Atëherë, në votim kanë marrë pjesë 62 deputetë.

Për kanë votuar 55. Kundër s'ka votuar askush.

Kanë abstenuar 7.

Atëherë Kuvendi emëroi zotin Avdullah Aliun anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore me mandat njëvjeçar.

5. Votimi i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës

Të nderuar deputetë!

Komisioni FunkSIONAL ka kërkuar që ky projektligj të radhitet në seancë plenare së bashku me përmirësimin teknik të amendamentit 32, i cili është miratuar në seancën plenare të mbajtur më 8 korrik 2016.

Sqarim procedural lidhur me kërkesën e Komisionit FunkSIONAL. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës ka qenë rend dite në seancën plenare të mbajtur më 7 dhe 8 korrik 2016. Në këtë seancë janë miratuar 35 amendamente, të propozuara në këtë projektligj. Në votimin e projektligjit me amendamentet e miratuar nuk kanë marrë pjesë në votim të paktën 61 deputetë, domethënë s'ka pasur kuorum për të marrë një vendim. Andaj, sot vazhdojmë me votimin e tekstit të projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuar.

Lidhur me kërkesën e Komisionit FunkSIONAL, kërkoj sqarim nga kryetari i komisionit, zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Zoti nënkryetar i Kuvendit!

Komisioni ka pasur disa diskutime të deputetëve, por edhe ekspertët e standardizimit na kanë kërkuar që një pikë që i ka trajtuar bashkë edhe investimet publike, domethënë pronën publike qendrore dhe investimet komunale, kanë qenë në një pikë, tash janë ndarë në dy pika, por përmbajtja e tekstit ka mbetur krejtësisht e njëjtë.

Në qoftë se ko paraqet problem procedural,unë mendoj që ligji në përmbajtje nuk humb shumë, por kështu është më e qartë, qysh kemi thënë. Kaq! Le të vendosni ju a doni ta korrigjoni atë amendament apo shkojmë drejt.

KRYESUESI: Atëherë, unë kërkoj deklarinimet e grupeve parlamentare. Për PDK-në kush flet? Shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Kryesues,

Anëtarë të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka vlerësuar si të rëndësishëm këtë projektligj, pavarësisht se në seancën tjetër që është shtyrë ka pasur edhe debate, shpeshherë edhe shtrembërime të qëndrimeve në opinion. Ne kemi trajtuar, mendojmë që duhet ta mbështesim këtë projektligj në mënyrë që të hapen rrugë dhe institucionet e vendit të kenë mundësi edhe më të mëdha për investime të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi ynë Parlamentar e mbështet dhe do të votojë pro këtij projektligji jashtëzakonisht të rëndësishëm për ne si shtet. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, Glauk Konjufca për Lëvizjen “Vetëvendosje”.

GLAUK KONJUFCA: Amendamenti që është propozuar nga komisioni është një qartësim teknik i çështjes për të cilën po bëhet fjalë, mirëpo ligji në përgjithësi nuk e mbron në mënyrën më të mirë interesin ekonomik të Republikës së Kosovës përballë investitorëve.

Kështu që ne do ta votojmë kundër, nuk është ndërtuar ky ligj, nuk është formuluar në mënyrën më të mirë të mundshme.

KRYESUESI: Duda Balje, për “6+” e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

S obzirom na to da smo svesni koliko ovaj Zakon značajan za strane investitore i za investicije na Kosovu, i koliko će to direktno utiče na ekonomski razvoj naše države, parlamentarna grupa 6+ podržaje ovaj Zakon.

KRYESUESI: Faleminderit! Zafir Berisha për “Nismën” e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Grupi Parlamentar i “Nismës” ka dhënë edhe mendimet rreth këtij ligji. Mendojmë se me këtë ligj nuk mbrohet interesi publik, interesi i qytetarëve dhe interesi i shtetit. Kemi dilema, prandaj ne do të abstenojmë në këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, shefi i Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: I nderuar kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,
Sa i përket votimit, ne kemi paqartësi për këtë ligj dhe nuk i mbrojmë interesat e investitorëve, ka dilema dhe Aleanca do ta abstenojë.

KRYESUESI: Faleminderit! Ne dëgjuam komentet për ligjin, çështja procedurale tash është: këtu është një nen, neni 22, është votuar si amendament. Tash kemi një precizim që ofron komisioni. Ju lutem, kërkoj të votohet për precizimin që ka kërkuar Komisioni Funkcional, në mënyrë që pastaj ta votojmë si tërësi ligjin.

Kërkoj që të votohet, votojmë tash për këtë propozim.

Faleminderit! Në votim kanë marrë pjesë 83 deputetë. Për kanë votuar 65, kundër kanë votuar 7, kanë abstenuar 11. Atëherë, është votuar rishtas amendamenti me plotësimet e Komisionit Funkcional.

Ju lutem, tash e vë në votim ligjin me të gjitha amendamentimet, përfshirë këtë që bëmë sot, ju lutem, bëhuni gati për votim, votojmë tash.

Në votim kanë marrë pjesë 82 deputetë.

Për kanë votuar 57. Kundër 14. Kanë abstenuar 11. Ju njoftoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për investimet strategjike të Republikës së Kosovës.

6. Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës

Të nderuar deputetë!

Diskutimet kanë përfunduar në seancën e kaluar, por në mungesë kuorumi, nuk është proceduar për votim Propozim-rezoluta e paraqitur nga përfaqësuesi i kërkesës për interpelancë. Andaj, sot vazhdojmë votimin e Propozim-rezolutës të paraqitur në Kuvend nga deputeti Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga gjashtë deputetë nënshkrues.

Ka mbaruar diskutimi, ne vetëm kemi të votojmë. Urdhëro! Kërkohet deklarimi me votim për rezolutën e propozuar, bëhuni gati, votojmë tash!

Në votim kanë marrë pjesë 72 deputetë.

Për kanë votuar 29 deputetë. Kundër kanë votuar 37 deputetë. Kanë abstenuar 6 deputetë. Nuk është votuar rezoluta e propozuar nga Visar Ymeri, e mbështetur nga gjashtë deputetë nënshkrues në lidhje me kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës.

7. Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës

Të nderuar deputetë!

Ka përfunduar në seancën e kaluar i gjithë diskutimi, edhe parashtrimi i tekstit final nga propozuesi, por në mungesë të kuorumit nuk është proceduar për votim Propozim-rezoluta e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.

Andaj, sot vazhdojmë me votimin e Propozim-Rezolutës të paraqitur në Kuvend nga deputeti Ismajl Kurteshi, i mbështetur nga 7 deputetë. Ismajl, një minutë e ke.

ISMAJL KURTESHI: Ajo që po kërkoj unë, meqë kanë kaluar shumë ditë dhe një pjesë e deputetëve s'ka qenë këtu, unë po dua vetëm të lexoj Rezolutën që e merr gjysmë minute. Gjysma nuk e dinë çka janë duke votuar, prandaj kërkoj të lexoj rezolutën, jo të diskutoj.

KRYESUESI: Faleminderit! Mos bëni zhurmë, ai e tha çka pat, e qes në votim Propozim-Rezolutën lidhur me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, votojmë tash.

Në votim kanë marrë pjesë 70 deputetë. Për kanë votuar 28 deputetë. Kundër kanë votuar 35 deputetë. Kanë abstenuar 7 deputetë. Konstatohet se Kuvendi nuk e miratoi Rezolutën e propozuar nga deputeti Ismajl Kurteshi, i mbështetur nga shtatë deputetë nënshkrues në lidhje me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-117 për akreditim

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendi i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj zonjën Hykmete Bajramin, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e këtij projekti legjislativ, shkurtimisht të paraqes arsyen, qëllimin, rëndësinë dhe fushën e rregullimit për përmbajtjen e Projektligjit për akreditim.

Projektligji për akreditim përcakton parimet e akreditimit dhe rregullat për akreditimin e trupave të vlerësimit të konformitetit që kryejnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit në Kosovë dhe gjithashtu fuqizon Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës.

Arsyeja për hartimin e këtij projektligji për akreditim është përmirësimi dhe plotësimi i legjislacionit ekzistues, inkorporimi i standardeve dhe procedurave për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, si dhe përmirësimin e gjithë sistemit të akreditimit në Kosovë, i cili do të harmonizohet me legjislacionin dhe praktikën e BE-së që kanë të bëjnë me akreditimin.

Po ashtu, arsye tjetër është edhe zgjerimi i aktiviteteve në fusha të reja të akreditimit, duke u bazuar në nevojat e palëve të interesit, duke përfshirë edhe akreditimin e laboratorëve medicinalë, ngritjen e nivelit të kompetencës së të gjithë pjesëmarrësve në procesin e akreditimit, si dhe stafit permanent të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, duke përfshirë këtu edhe involvimin e ekspertëve nga jashtë, përmirësimin e infrastrukturës për bashkëpunim me palët e interesit, ministritë përkatëse, konsumatorët, trupat për vlerësim të konformitetit të akredituara, si dhe asociacioneve të tjera, me qëllim të përfshirjes më të madhe të të gjitha palëve të interesit në të gjitha proceset akredituese.

Arsye tjetër për këtë projektligj është edhe plotësimi i obligimeve ligjore të Republikës së Kosovës, të cilat rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Kështu që nenet: 20, 75, 80 të MSA-së përcaktohet obligimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës që të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar gradualisht përputhshmërinë me rregulloret teknike të Bashkimit Evropian dhe procedurave evropiane të vlerësimit të standardizimit dhe akreditimit.

Adaptimi dhe aplikimi i procedurave dhe standardeve të parapara me legjislacionin e Bashkimit Evropian do të ndihmojë Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe vetë Republikën e Kosovës rreth njohjes ndërkombëtare të akreditimit të Kosovës, gjë e cila do të ndikojë në përmirësimin e mëtutjeshëm të cilësisë së produkteve, të cilat prodhohen në vend.

Ky përmirësim do të ndikojë gjithashtu dhe do të kontribuojë që ndërmarrjet tona të kenë më të lehtë që të eksportojnë. Do të kenë kosto më të ulët për produktet e tyre dhe gjithashtu rritje të konkurrencës në tregjet vendore dhe në tregjet e huaja.

Të nderuar deputetë,

Unë ju njoftoj se ne si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë kemi respektuar të gjitha rregullat dhe procedurat për hartimin e projektligjit, gjithashtu kemi përshkuar ligjin nëpër diskutim të brendshëm dhe të jashtëm. Andaj, unë kërkoj sot mirëkuptimin tuaj dhe kërkoj që ta mbështesni këtë ligj në lexim të parë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes plenare e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë! Pas procedimit të projektligjit, e hap debatin për diskutim, në parim.

Në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik. Fjalën e ka deputeti Enver Hoti. Atëherë, nuk ka nga komisioni. A ka nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Profesor Muhamet Mustafa në emër të komisionit.

MUHAMET MUSTAFA: Zoti Hoti është udhëheqës i grupit për këtë, por meqë nuk është këtu, unë vetëm po theksoj se komisioni ka përkrahur ligjin, e vlerëson shumë të rëndësishëm. Ajo që duhet të trajtohet në leximin e dytë dhe duhet të shqyrtohet me kujdes janë dispozitat që kanë të bëjnë me emërimin e Këshillit Profesional dhe Këshillit të akreditimit. Këtu do të na duhet të shohim, sepse komisioni ka vërejtje lidhur me këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka asnjë grup parlamentar... Zoti Beqa e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Ky ligj është me rëndësi të veçantë për vendin. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar Projektligjin për Akreditim. Në këtë fazë e përkrahim në parim, kurse gjatë dy leximeve si grup parlamentar do ta japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka, e tha profesori. Urdhëroni, zoti Rexhepi, Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Unë, përveç që kemi marrë pjesë në komision dhe pajtohem me atë që e tha kryetari lidhur me projektligjin, po ashtu në emër të LDK-së megjithatë do t'i japim përkrahje të plotë edhe punën e mirë që e ka bërë ministrja në kuadër të këtij projektligji dhe unë besoj, që në leximin e dytë bashkërisht do t'i bashkëngjisim edhe ato rekomandime që u thanë këtu pak më herët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca nga Lëvizja “Vetëvendosje” e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Të gjitha këto që u thanë dhe që i dëgjuam deri më tash janë vetëm masa formale, që po ndërmerren, po unë mendoj se cilësia e produkteve në Kosovë nuk përmirësohet automatikisht veç pse po e themelojmë një Agjenci apo një drejtori të akreditimit, e cila do të merret enkas me këtë punë. Domethënë, duhet shumë masa e masa të tjera kualitative në shtetin e Kosovës, në Republikën e Kosovës, që produktet tona ta marrin edhe atë... le të themi, kualifikimin e konformitetit, siç po quhet këtu.

Prandaj, ne e kemi shqyrtuar këtë projektligj. Vërejtjet tona kanë të bëjnë më shumë prej nenit 11 deri në nenin 15, ku ekspertët tanë juridikë kanë konkluduar se mund të ketë ndoshta, le të themi, probleme sa u përket kompetencave në mes të drejtorit të agjencisë dhe organeve të tjera që themelohen përmes këtij ligji.

Po ashtu, në ligj kemi vërejtur edhe disa paragrafë, të cilët nuk kanë kuptim logjik. Kështu që, të gjitha këto do t'i përmirësojmë, do të mundohemi t'i përmirësojmë gjatë procesit, kur ky projektligj do të shqyrtohet përmes amendamenteve të ndryshme, që ne do t'i propozojmë.

Desha vetëm, për shembull, ta lexoj këtë fillimin e ligjit, nuk e di kush e ka shkruar këtë, por kjo nuk ka kuptim logjik. Për shembull, thuhet: "Ky ligj përcakton parimet e akreditimit dhe rregullat për akreditimin e trupave të vlerësimit të konformitetit". Pastaj thotë që "kryen aktivitete të vlerësimit të konformitetit". Kjo nuk ka kuptim logjik. Kjo duhet të ndryshohet. Thjesht, duhet të bëhen rregullat për akreditimin e trupave të vlerësimit të konformitetit, që kryejnë aktivitete të konformitetit në Kosovë. Pra, thjesht kjo shndërron këtë artikulum në një formë të tautologjisë. Të gjitha këto duhet të përmirësohen. Ka edhe vende të tjera, kështu ku ka gabime logjike. Nuk po e di a janë drejtpërdrejtë pasojë e, le të themi, ekspertëve që i kanë formuluar në këtë mënyrë apo janë ndoshta pasojë e përkthimit të ndonjë ligji, që ju e keni pasur parasysh apo që ju do të mund ta keni marrë si bazë, prej vendeve të ndonjërit nga vendet e BE-së, që e rregullon këtë problematikë.

Do t'i shikojmë të gjitha këto dhe do t'i parashtrojmë këto përmirësime në formë të amendamenteve për këtë ligj.

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë, Zafir Berishën e kam në monitor. Pal Lekaj. Më fal, Zafir. Lajmërohuni ju lutem, se nuk po e di. Urdhëro Pal Lekaj, pastaj Zafir Berisha është.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ne e kemi analizuar ligjin. Ka vërejtje, ka defekte dhe këto do të mundohemi që t'i përmirësojmë në formë të shkruar me amendamentimi, propozuar nga grupi ynë, por në këtë e përkrahim në përgjithësi këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zafir Berisha, urdhëroni, fjala për ju!

ZAFIR BERISHA: Faleminderit! Në mungesë të shokut Enver, i cili është jashtë shtetit, unë jam i autorizuar që në emër të “Nismës” të them, se këtë projektligj në parim do ta përkrahim. Vërejtjet dhe sugjerimet tona do t’i japim në grupet punuese dhe në komisionin adekuat. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në ndërkohë, Duda Balje e ka fjalën, në emër të “6+”-it.

DUDA BALJE: Parlamentarna Grupa “6+” podržace zakon u prvom čitanju. Sve ono što imamo da odamo, dodaćemo kroz rad u komisiji. Hvala!

KRYETARI: Hajdar Beqa është i vetmi deputet i cili e ka kërkuar fjalën.

HAJDAR BEQA: Kryetar!

Ndoshta është më herët që fola, nuk kam kërkuar në këtë, por ndoshta gabim teknik.

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë më tutje. Nuk ka deputetë. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk ka kërkuar fjalën.

Të nderuar deputetë,

Jemi në procedurën ku kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit.

Kisha kërkuar nga kolegët deputetë, se vetëm 52 vetë i kemi në sallë, që t’i thërrasin kolegët deputetë dhe të përgatitemi për votim.

Të nderuar kolegë deputetë, përgatitemi për votim. Deputetët që kanë hyrë në sallë le të zënë vendet. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Aktualisht jemi 64 deputetë në sallë. Votojmë tash!

63 deputetë kanë votuar, 62 për, 1 kundër, asnjë abstenim. Kuvendi aprovoi në parim Projektligjin për akreditim.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

Komisionet e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. E ftoj kryetarin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, zotin Nait Hasani, që të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe ka bërë amendamentimin e tij, ka nxjerrë 6 amendamente, i ka proceduar nëpër të gjitha komisionet funksionale, të gjitha janë pajtuar dhe nuk kanë vërejtje. Ky ligj i plotëson kushtet dhe të drejtat e përafërta me Bashkimin Evropian, me *acquis communautaire*. Prandaj, kërkoj nga deputetët që ta miratojnë dhe t'i japim një mundësi që të miratohet ky projektligj dhe ti jap të drejtën e mbrojtjes së të drejtave të autorëve.

Ky projektligj ka përparësitë, një prej tyre është që të drejtat e autorit në Kosovë janë mbrojtur dhe në një formë më të vogël, kurse me këtë ka mundësi të mbrohen me shumicë, pikërisht në amendamentet të cilat janë bërë, ku një nga ato mbrojtje është edhe mbrojtja e medieve, që e drejtë e autorit dhe e drejtë e përafërt. Prandaj, po kërkoj që deputetët ta miratojnë dhe t'i japim mundësinë për mbrojtjen e të drejtave të tyre të autorëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në këtë projektligj nga Komisioni Funkcional janë propozuar gjithsej 6 amendamente. Nuk ka asnjë deputet të lajmëruar për diskutim.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit Funkcional. Para votimit vetëm ta konstatojmë praninë e deputetëve. Në sallë i kemi 3 deputetë janë duke shkuar, 4 po largohen, sa po mbeten? Një minutë, deputetë! Gjysmë minute e keni për votim. Urdhëro Ismajl, fjala është për ty, na e thërret kuorumin.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Në lidhje me këtë ligj, të cilin ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar dhe nuk kemi vërejtje dhe se një ligj i tillë është shumë i nevojshëm, por dëshiroj që në emër të grupit t'ia tërheq vërejtjen Ministrisë së Arsimit dhe Qeverisë së Kosovës, se krahas me këtë ligj është më se e nevojshme, që bibliotekat në vend të furnizohen me tekste, sidomos bibliotekat universitare, pasi që studentët të cilët janë furnizuar me tekste të kopjuara, që u kanë kushtuar shumë më lirë, tash kjo mundësi nuk do të ekzistojë.

Ka tekste universitare, të cilat kushtojnë edhe mbi 50 euro për shumë studentë janë të paarritshme. Është mirë, që si rekomandim t'i shkojë ministrisë së arsimit, që t'i furnizojë këto

biblioteka me tekstet universitare, në mënyrë që ky ligj të mos i pengojë ata që të kenë qasje në tekstet e tyre, që janë shumë të domosdoshme për dhënien e provimit dhe avancimit në shkencë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë, votojmë të 6 amendamentet, një nga një.

72 deputetë i kemi në sallë. Unë do të pyes vetëm kush është kundër dhe abstenim, pastaj pranohet për secilin amendament veç e veç.

Amendamenti 1. A ka kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 2. A ka kundër? Abstenim? Kalon.

72 deputetë në sallë.

Amendamenti 3. A ka kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 4. A ka kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 5. A ka kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 6. A ka kundër? Abstenim? Kalon.

Votojmë tekstin në tërësi me amendamentet e miratuara. Jemi 73 deputetë në sallë, u bëmë 74. Përgatitemi për votim. Lus regjinë dhe deputetët, që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

72 deputetë kanë votuar. 60 kanë votuar për, 12 kanë abstenuar. Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Të nderuar kolegë deputetë, jemi në pikën e radhës:

10. Zgjedhja e një anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Komisioni Funkcional i ka shqyrtuar propozimet për emërimin e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e Shoqërisë Civile dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e njërit prej kandidatëve të propozuar, si në vijim:

1. Shemsi Jashari,
2. Ilir Dukolli, dhe
3. Naim Krasniqi.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, zonjën Albulena Haxhiu, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

Kush do të flasë në vend të zonjës Haxhiu? Atëherë, na duhet deklarimi i përfaqësuesve, ose kryetarëve të grupeve parlamentare për këtë çështje. PDK-ja, Zenun Pajaziti.

Kërkoj falje, të nderuar kolegë! Në qoftë se, dëshironi e vazhdojmë këtë pikën... A dëshironi të futemi në votim të fshehtë apo dëshironi të kalojmë në pikën e radhës menjëherë? A do ta lëmë më vonë këtë? Cila është... Shqyrtimi i raportit për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Mirë, e kryejmë votimin. Po shkojmë! Urdhëroni, zoti Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Zoti kryetar,

Veç një komision më duket është tërhequr për një aktivitet tjetër. Ndoshta, do të ishte mirë të zhvendoset ky, në mënyrë që të jenë të gjithë deputetët këtu për votimin e fshehtë, që të mos ua heqim mundësinë deputetëve, së paku këtyre që janë në ndërtesë të Kuvendit, që të votojnë.

KRYETARI: Atëherë, Grupi Parlamentar i LDK-së, e qesim në votim, seanca vendos.

KRYETARI: Fjalën e ka zoti Mustafa. Dëshirojmë ta zhvendosim apo të procedojmë?

MUHAMET MUSTAFA: Të zhvendoset, sepse me të vërtetë t'i kryejmë këto dy pika e mandej, se votimi... po humbet dinamika pastaj.

KRYETARI: Faleminderit! Lëvizja “Vetëvendosje” e pati qëndrimin e qartë. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës çfarë qëndrimi ka? Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është për ta zhvendosur këtë pikë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! “Nisma për Kosovën”, pastaj menjëherë “6+”-i. Kush e do fjalën prej “Nismës për Kosovën”, Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Është mirë të zhvendoset, por sido që të jetë, më duhet të them se edhe unë jam në atë komisionin që ikën kolegët, sepse mendoj se seanca plenare është më e rëndësishme se takimet e komisionit. Me këtë rast kërkoj përgjegjësi më të madhe nga kolegët, për t'i dhënë kuptim Kuvendit. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Kujtim Paqaku për “6+”.

KUJTIM PAQAKU: I nderuar kryesues,
Edhe Grupi Parlamentar “6+” mendon se kjo pikë e rendit të ditës duhet të zhvendoset.

KRYESUESI: Atëherë, kërkoj një votim formal. Shumica donë që këto dy pika të trajtohen para se të vijë pika e votimeve të fshehta.

Ju lutem, me ngritje dore, kush është për? Kundër?

Lëvizja “Vetëvendosje” është kundër. Shumica janë për. Vazhdojmë me punë!

Kalojmë në pikën njëmbëdhjetë:

11. Shqyrtimi i raportit për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Komisioni FunkSIONAL ka shqyrtuar raportin për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Në emër të komisionit, deputetja Xhevahire IzmaKu. Xhevahirja nuk është këtu. Atëherë, në emër të komisionit, Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie në bazë të nenit 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 26. 9. 2016 shqyrtoi raportin vjetor për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe vendosi, që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim:

1. Të miratohet raporti vjetor për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015; dhe
2. Arsyetimin e raportit me rekomandimin e paraqet nënkryetari, zëvendëskryetari Sadri Ferati.

Arsyetim:

Në bazë të nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës i raporton Kuvendit të paktën një herë në vit për gjendjen në Shërbimin Civil, pra siç po ndodh. Prandaj, edhe një herë ju lusim që ta votojmë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të grupeve parlamentare, Agim Aliu, për PDK-në.

AGIM ALIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar nënkryetar,

Të nderuar ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne si grup parlamentar i Partisë Demokratike kemi diskutuar dhe trajtuar raportin vjetor për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Raporti në vetvete përmban një punë të mirë, që është bërë në kuadër të mbikëqyrjes dhe shqyrtimit të ankesave të nëpunësve civilë, si dhe rreth mbikëqyrjes së emërimeve të nëpunësve të nivelit drejtues, nëse janë bërë apo jo në përputhje me rregullat dhe Ligjin për shërbyesit civilë në Republikën e Kosovës.

Pavarësisht të dhënave në këtë raport, ne konsiderojmë se duhet akoma angazhim shtesë rreth kësaj mbikëqyrjeje, sepse kemi raste kur edhe pas kthimeve në punë të shërbyesve civilë nuk kemi pasur respektim të këtyre vendimeve.

Konsiderojmë, se duhet një punë rigoroze në mbrojtje të shërbyesve civilë, në mënyrë që të mos ketë privim nga puna, të mos ketë avancime të padrejta dhe për çështje të paarsyeshme dhe, për më keq, edhe për çështje të natyrës politike. Të mos ketë ndërprerje të marrëdhënies së punës, e cila nuk është bazuar në Ligjin për shërbyesit civilë, të mos ketë masa disiplinore për çështje preferenciale, të trajtohet çështje e moszbatimit të vendimit të Komisionit të Ankesave, degradime dhe çështje të tjera.

Pavarësisht se akoma ka punë të madhe në këtë drejtim, që të trajtohen dhe sensibilizohet e drejta e pamohuar ligjore e shërbyesve civilë dhe e padrejta që bëhet ndaj tyre, në disa raste të theksuara, ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike mbështesim rekomandimin e komisionit dhe i japim mbështetje miratimit të këtij raporti.

KRYESUESI: Për LDK-në kush flet? Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah raportin dhe do të angazhohet që ta votojmë, ndërsa nga informacionet që kemi edhe në vetë komisionin ne vlerësojmë, se ky raport është diskutuar në komision edhe me prezencën e ministrit, që për të satën herë, është shumë bashkëpunues dhe merr pjesë edhe personalisht nëpër këto takime.

Nga ana tjetër, edhe pse kemi një qartësim, pra një koncept më të qartë se sa viteve të kaluara, sa u përket vetë shërbyesve civilë, unë mendoj se do të duhet një angazhim akoma më i madh, jo vetëm i ministrisë, por në përgjithësi si një sistem sa u përket shërbyesve civilë, nga se rezultatet akoma mungojnë.

Kemi situata, sidomos tek rekrutimet, ne jemi akoma në vullnetin e subjektivitetit të vlerësimit dhe kemi kur një intervistë njëminutëshe është determinuese dhe më përcaktuese se sa gjithë performanca që e ka një kandidat me gjithë shkollimin, përvojën dhe me gjithë notat dhe vlerësimet që i ka pasur paraprakisht. Kjo duhet sa më shpejt të eliminohet, të gjenden forma, mënyra që të vijë në shprehje kualiteti i kandidatëve që do të konkurrojnë, sepse kjo përveçse do ta kishte përmbushur depolitizimin, kjo de-facto krijon edhe një nivel më të lartë, edhe një intelektualizëm dhe profesionalitet më të lartë në fazat e rekrutimit.

Pastaj, ne kemi një sistem që për shkak të autonomisë së veprimeve përbrenda, ne kemi sistem ku nuk kemi edhe shumë mundësi të vlerësimit brenda institucioneve tjera. Përveç kësaj pjese që udhëheq Ministria e Administratës, në kuptimin e krijimit të planifikimeve dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Për Lëvizjen “Vetëvendosje” a dëshiron të flasë?

SADRI FERATI: Atëherë, pra unë thërras që të votohet ky raport.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Lëvizjen “Vetëvendosje”, Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Raporti i vlerësimit të gjendjes në Shërbimin Civil të cilin ne po e shqyrtojmë sot, ndonëse ka disa përmirësime në raport me atë që ne e kemi shqyrtuar vitin e kaluar, por siç e ka pranuar edhe vet ministri, kur këtë raport e kemi shqyrtuar në Komisionin për Administratë Publike, i mungojnë shumë të dhëna, sidomos ato analitike.

Ka mjaft statistika, por jo çdoherë statistikat flasin ose tregojnë për gjendjen që mbretëron brenda Shërbimit Civil dhe për këtë dua ta marr vetëm një shembull. Ndonëse, Ligji për shërbimin civil i parasheh qartë cilat janë kriteret për të punësuarit në Shërbimin Civil, do të thotë cilat janë kushtet, kriteret, që ata duhet plotësuar, njëri prej tyre duke qenë arsimi, ne ende në sektorin civil kemi 310 të punësuar me shkollim fillor, për të cilët nuk e dimë saktësisht se çfarë pozitash mbajnë këta njerëz dhe si ka pasur mundësi, që fillimisht të merren në punë njerëz që nuk kanë plotësuar kriterin bazë e që është kriteri i shkollimit.

Në raport, po ashtu përshkruhen më shumë se cilat janë detyrat e institucioneve, për shembull në Departamentin për Administrim dhe Menaxhimin e Shërbimit Civil, në vend se aty të ofrohen të dhëna dhe sidomos, analiza se si dhe sa janë kryer këto aktivitete dhe mbi të gjitha, cilat kanë qenë rezultatet e arritura. Në fakt, vlen të përmendet megjithatë si një e arritur, krijimi i sistemit të informimit për menaxhimin e burimeve njerëzore. Mirëpo, zbatimi në praktikë i këtij sistemi

nuk ka funksionuar siç duhet, ndonëse këtë nuk e thotë raporti për gjendjen në Shërbimin Civil, një gjë të tillë e thekson raporti i Këshillit të Pavarur për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Kështu, ky këshill ka konstatuar se Ministria e Administratës Publike ka filluar zbatimin e sistemit elektronik të miratimit të kërkesave për autorizimin e procedurës së rekrutimit, por këtë nuk e ka bërë pasi ta ketë plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren 2/2011 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil, për të përcaktuar, domethënë me këtë rregullore do të përcaktoheshin procedurat dhe hapat e zbatimit të sistemit elektronik të këtij procesi.

Problemi kryesor në Shërbimin Civil vazhdon të mbetet procesi i rekrutimit dhe pranimi në Shërbimin Civil, gjë që e përmendën edhe dy parafolësit. Edhe kjo theksohet në raportin e Këshillit të Pavarur, i cili ka konstatuar se institucionet e Administratës Publike nuk kanë arritur në nivelin e kënaqshëm të zbatojnë dispozitat e përcaktuara me aktet ligjore dhe nënligjore, lidhur me procedurën e rekrutimit dhe pranimi të nëpunësve në Shërbimin Civil, qoftë përmes procedurave të avancimit apo procedurave të jashtme të rekrutimit.

Në bazë të të dhënave që Këshilli ka grumbulluar, ushtrimi i funksioneve kushtetuese dhe ligjore, është konstatuar se shkeljet më të shpeshta gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit janë si në vijim:

- mosrespektimi i afateve për zhvillimin e procedurave të rekrutimit;
- mosmarrja e autorizimit për shpalljen e konkursit nga Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike;
- lëshimi i autorizimit për shpallje nga ky departament me kritere të ndryshme për pozita të njëjta;
- themelimi i Komisionit Përzgjedhës për Shërbimin Civil në kundërshtim me dispozitat ligjore;
- dështimi i Këshillit për llogaritjen e përvojës së punës së kandidatëve për pranim në Shërbim Civil;
- përgatitja e tekstit me shkrim dhe me gojë, në kundërshtim me dispozitat ligjore.

I theksova me qëllim këto të gjetura të këshillit, sepse të gjitha këto mandej natyrisht se ndikojnë kualitetin e njerëzve të cilët rekrutojnë për të mbajtur pozita në kuadër të Shërbimit Civil.

Po ashtu, për të pasur një pasqyrë më të qartë rreth gjendjes në Shërbimin Civil, janë edhe raportet tjera të cilat duhet konsultuar, si ato të nxjerra nga organizata të ndryshme joqeveritare

që kanë bërë vlerësimin e punës së Shërbimit Civil, por mbi të gjitha, Raporti i Progresit të Komisionit Evropian i cili për çdo ditë thekson, pothuajse, probleme të njëjta të cilat i evidenton në kuadër të Shërbimit Civil. Dhe, një nga problemet që është theksuar edhe në këtë raport është fakti se në Shërbimin Civil ende për pozitën e njëjtë njerëzit nuk paguhen njëjtë, ndonëse ka filluar zbatimi i katalogut të klasifikimit të vendeve të punës, megjithatë kjo ende vazhdon të mbetet një sfidë dhe kjo për faktin, se ministria për arsye që ne ende nuk i dimë, ndonëse këtë është dashur ta bëjë qysh viteve të kaluara, nuk e ka sjellë Ligjin për pagat në Administratën Publike.

Një çështje tjetër, një shqetësim tjetër, i cili ngritet më shumë tek raporti i Këshillit të Pavarur të Shërbimit Civil, se sa në raportin që ne po shqyrtojmë, është edhe vlerësimi i rezultateve të nëpunësve civilë, e cila natyrisht se mandej ndikon në cilësinë e punës së këtyre të punësuarve në administratë.

Në raportin për mbikëqyrjen e Shërbimit Civil janë evidentuar një serë të metash në procesin e vlerësimit. Aty thuhet se Këshilli konstaton se vlerësimi i punës së nëpunësve civilë nuk bëhet në pajtim me objektivat dhe aktivitetet e nëpunësve civilë, sepse në shumë raste mungojnë planet vjetore të nëpunësve civilë mbi bazën e të cilave do të duhej të kryhej vlerësimi i punës së nëpunësve civil. Po ashtu, vlerësimi i punës së nëpunësve civilë bëhet jashtë afateve të përcaktuara ligjore dhe në disa raste është vlerësuar se tek pozitat e nivelit drejtues dhe tek pozitat e nivelit të lartë drejtues, vlerësimi i punës së tyre nuk bëhet me vite të tëra dhe kjo bie mandej në konkluzionin, se megjithatë Shërbimi Civil vazhdon të mbetet skajshmërisht i politizuar dhe me mungesa të mëdha të cilësisë në përditshmërinë e punëve që ata kryejnë.

Prandaj, duke u bazuar edhe në këto, por edhe në mangësi tjera që ka raporti, ne nuk mund ta votojmë pozitivisht këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Sa i përket raportit, është i përgjithësuar dhe nuk është bërë në atë çka ndodhë në terren dhe sa i përket performancave apo synimeve të reformës në administratë, nga ky raport kemi parë se jemi larg standardeve që i kërkon edhe koha, por edhe standardet e Bashkimit Evropian.

E bazoj këtë, sepse nëse nisemi nga procesi i rekrutimit ka shkelje drastike në shumë departamente, në institucione e sidomos edhe nëpër komuna. E them këtë, sepse më tepër në sistemin e procesit të rekrutimit dominon nepotizmi, politizimi i skajshëm dhe interesi

individual, jo performanca apo arsimimi çfarë kërkohet. Dhe, në këtë drejtim ne jemi shumë larg të asaj për çfarë jeni zotuar si Qeveri dhe mund të them që ka laramani në shumë departamente.

Po ashtu, kur jemi tek... sa u përket kritereve të performancës, mendoj se nuk është e drejtë, sepse shumë institucione apo departamente nuk e bëjnë në bazë të ligjit performancën në gjashtëmujorin e parë dhe në përfundim të vitit fiskal, por ajo bëhet shkel e shko dhe fare nuk keni ndërmarrë asgjë.

Sa i përket tjetrës që e kemi veçuar, kur jemi te Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ne mendojmë se ka shumë që janë kthyer nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës prapë për të vlerësuar performancën e tyre, që nuk është përputhur me kërkesat e institucioneve e sidomos nëpër komuna. Aty ka shkelje drastike, sepse punëtorët edhe pse marrin vlerësim pozitiv nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës nuk kthehen nëpër vende të punës dhe sot e kësaj dite, nuk respektohet vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

Kur jemi te kontratat mbi vepër, mendoj se edhe këtu nuk e keni saktësuar në raport, sepse ka shumë institucione që edhe pse është e kundërligjshme, ka punëtorë edhe me gjashtë muaj kontratë mbi vepër dhe nuk e keni potencuar fare këtë. Prandaj, në këtë raport ne kur jemi edhe te ndërprerja e punës, mund të them që nuk ndërpritet puna ad hoc, por në bazë të vlerësimeve dhe shkeljeve disiplinore dhe edhe komisionet sa u përket atyre disiplinore, nuk veprojnë ashtu siç kërkon ligji, por ka mangësi shumë të mëdha.

Prandaj, ne mendojmë që ka një përmirësim sa i përket, nëse nisemi nga viti në vit, mirëpo jemi larg synimeve tona dhe larg atyre reformave që i dëshirojmë dhe që punëtorët të zgjidhen sipas përgatitjes profesionale e jo sipas interesave të individëve të caktuar apo politikës ditore. Dhe, në këtë drejtim mendoj se ministria mund të bëjë shumë duke respektuar ligjet në fuqi, të cilat shkelen për çdo orë apo për çdo ditë.

Mendoj se krejt fokusi i juaj si ministër i Administratës Publike mund të jetë këtu në respektimin e ligjeve, që janë miratuar nga ky vend dhe nga Kuvendi në përgjithësi, dhe kjo të jetë një mësim për të gjithë ata që kanë përgjegjësi e sidomos, që të kemi një administratë profesionale.

Këtë po e them dhe kërkoj nga ju, që të ndikoni në bazë të ligjeve që janë në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të “Nismës”, Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Edhe pse, ka nuanca pozitive në raport me vitet e kaluara, mendoj se ky raport nuk i plotëson kushtet për ta marrë besimin e deputetëve, për shkak se ka vazhdimësi të shkeljeve që ndodhin në Shërbimin Civil. Mendoj se nuk janë të saktësuarat qartë, unë edhe në komision e kam thënë,

sepse nga papërgjegjësia e shërbyesve civilë, edhe në raste tjera e kam përsëritur, kemi edhe dëmtim të Buxhetit të konsoliduar të shtetit dhe mendoj se ministri duhet të ketë konsideratë dhe në ato statistika të radhiten edhe njerëzit që kanë dhënë dhe duhet të japin llogari për shkak të shkeljes së Ligjit për shërbyesit civilë.

Në emër të “Nismës” them se ne do ta votojmë kundër këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+”, Qerim Bajrami e ka fjalën.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovani ministre Jagđilar,

Poštovani poslanici,

I Parlamentarna grupa “6+” je razmatrala ovaj izveštaj i glasaće, dakle svaki poslanik po svojoj savjesti, o njemu s tim što mi koristimo priliku da pozdravimo angažman ministra Mahira Jagđilara vezano za njegovu koordinaciju rada sa Komisijom za zajednice u vezi problema nedovoljne zaposlenosti pripadnika nevećinskih zajednica u Republici Kosovo.

Naime i po broju koje je izdat, dakle o statistici i po strukturi, pogotovo zaposlenih odnosno kvalifikacijama, pogotovo na centralnom nivou, može se jasno vidjeti dakle iz ovog izvještaja da nema dovoljan broj zaposlenih u svim ministarstvima i drugim službama na centralnom nivou od strane pripadnika nevećinskih zajednica.

Drugi problem koji imamo, jeste da u nekim ministarstvima pogotovo u Ministarstvo za zajednice i povratak ima mnogo zaposlenih pripadnika od strane jedne nevećinske zajednice, dok drugih pripadnika nevećinskih zajednica gotovo da nema ili ima u minimalnom broju.

Također, da još jednom napomenem da bez obzira što sam kazao, da recimo nijedno ministarstvo nemamo ni sekretara na odgovornoj funkciji, nemamo direktora, i tako dalje... tako da ispada da mi pripadnici nevećinskih zajednica nemamo adekvatne stručnjake za ova mesta, što sad apsolutno nije tačno.

Ono što je također jako bitno a što se u ovom izvještaju ne viti a trebalo bi da se vidi, jeste fenomen lažno prijavljenih pripadnika nevećinske zajednice na mjestima pripadnika nevećinske zajednice. Dakle, pripadnika većinske zajednice koji su se izjasnili kao pripadnici nevećinskih zajednica i drže određena mesta u administraciji.

Imamo niz primera, nemamo ovde dovoljnog vremena da te primjere navodim. S ovim u vezi mi ćemo uskoro imati ispred Komisije za zajednice također naš izveštaj o nadgledanju Zakona o civilnoj službi, odnosno člana 11, i daćemo adekvatne predloge za izmenu i dopunu ili tog člana

ili za njegovo pojašnjenje preko izmena i dopuna administrativnih uputstava u ministarstvu i u drugim ministarstvima.

Jedna od naših predloga će biti da se formira baza podataka zaposlenih sa imenima i prezimenima. Također, ćemo preko ovoga tražiti i poboljšanje i uključivanje Vlade u problem nezaposlenosti nevećinskih zajednica, odnosno izdvajanje dodatnih budžetskih sredstava. U ovom pravcu mi pozdravljamo i angažman međunarodne zajednice da pomogne, pogotovo oko dodatnog zapošljavanja i da se dakle, shvati ovaj problem veoma ozbiljno, jer 10% zaposlenih pripadnika svih nevećinskih zajednica nije veliki, ne bi trebalo da bude veliki, kako predviđa zakon, ali ako nemamo ni tih 10% pogotovo na centralnom nivou, onda se postavlja pitanje: gde i kako se ispunjavaju naša prava, koja predviđa Ustav Republike Kosova i Zakon o civilnoj službi.

U svakom slučaju, još jednom ću napomenuti da mi očekujemo i ubuduće koordinaciju i sa ministarstvom, dakle i sa ministrom Jagđilarom i sa mnogim drugim ministarstvima, i sa Vladom, i sa Skupštinom normalno, da bi se ova pitanja razrešila i da bi se razrešila sva ona druga pitanja, koja dotiču administraciju i Civilnu službu uopšte na Kosovu da bi smo imali što efikasniju administraciju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupet janë deklaruar për këtë çështje, tash e kanë fjalën deputetët. Selville Halimi e ka fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Kur analizojmë raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, shohim se çdo ditë e më shumë apo në çdo vit raporti na vjen më i fokusuar dhe tregohet një punë mjaftë e përkushtuar e këtij këshilli me qëllimin e vetëm që ka, mbrojtjen e të drejtave të shërbyesve civilë, përcjelljen e procedurave të rekrutimit dhe kujdesin për zbatimin e ligjeve në Shërbimin Civil.

Për vitin gjatë periudhës raportuese, ky raport na jep 369 ankesa, të cilat janë bërë nga shërbyesit civilë apo aplikuesit në konkurse të ndryshme të Shërbimit Civil në nivelin qendror dhe këtu me ankesa prinë Ministria e Tregtisë e Industrisë me 34 dhe kemi 244 ankesa nga aplikuesit në konkurse apo nga shërbyesit civilë në nivelet lokale, ku këtu prinë komuna e Prishtinës me 61 ankesa.

Për mua nuk është shqetësim numri i shumtë i ankesave nëpër institucione, sepse për atë janë institucionet, për atë janë krijuar organet ku secili ka të drejtë të kërkojë mbrojtjen e të drejtës së vet, që mendon se ka të drejtë apo i është shkelur një e drejtë, por mua më shqetëson fakti se organet, si të nivelit qendror ashtu edhe atij lokal, gjithnjë sipas raportit, nuk zbatojnë vendimet e

Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, që kanë në esencë rekomandimin për korrigjimin apo për kthimin e të drejtave që u merren shërbyesve civilë apo aplikuesve nëpër konkurse.

E dimë se organi apo Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës është organi më i lartë dhe jep vendime të formës së prerë në procedura administrative për shërbyesit civilë dhe po qe se, institucionet e nivelit qendror apo lokal nuk i zbatojnë këto rekomandime, përkatësisht vendime të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, atëherë palët e ankimuara detyrohen që t'i drejtohen Gjykatës. Ne vazhdimisht në Kuvendin e Kosovës flasim për një jo azhurit të institucioneve të drejtësisë dhe në këtë rast ne, në nivelin qendror dhe lokal lejojmë që të ngarkohen gjykatat për shkak të moszbatimit të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, me të cilat vendime u mbrohen të drejtat qytetarëve, gjegjësisht Shërbimit Civil apo ankimuesve në procedurat e rekrutimit.

Unë mendoj se Qeveria duhet të jetë më e zëshme, si në nivel qendror ndaj të gjitha institucioneve, duke filluar nga vet institucioni i Kryeministrit, ashtu të kërkojë përmes Administratës së Pushtetit Lokal dhe Administratës Publike, që institucionet e nivelit lokal të jenë të përgjegjshme dhe të zbatojnë vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, kjo me të vetmin qëllim që t'u kthehen të drejtat shërbyesve civilë gjatë procedurave të ndryshme rekrutuese dhe ankimuesve të cilët aplikojnë në konkurse të ndryshme të Shërbimit Civil dhe të mos lejojnë ngarkimin e institucioneve të drejtësisë, për shkak të moszbatimit të rekomandimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga ana e institucioneve, sepse të gjitha e njohin këtë ligj dhe vendimet e tij me procedurë administrative janë vendime të formës së prerë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Veton Berisha e ka fjalën.

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues Hamiti!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra prezentë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që të jap kontributin tim në raport me këtë raport, i cili është paraqitur para nesh dhe të përgëzoj Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për një raport të tillë.

Edhe pse, raporti flet për vitin 2015, meqë unë përfaqësoj komunitetin egjiptian në Kuvendin e Kosovës dhe normalisht, që duhet t'i paraqes shqetësimet e mija në raport me gjendjen e punësimit të komunitetit egjiptian në Administratën Publike.

Po ua rikujtoj që Ligji për Shërbimin Civil, neni 11, parasheh që 10% të komuniteteve pakicë, minimumi 10% i komuniteteve pakicë, të jetë i rezervuar apo i paraparë për komunitetet. Në rastin tonë, unë jam përfaqësues, e udhëheq grupin punues për monitorimin e këtij neni dhe besoj se shumë shpejt ky raport do të dalë në Kuvend dhe do të dalim edhe me rekomandime në raport me pakënaqësitë, por ne këtu në këtë raport që kemi aktualisht para vetes, shprehim

pakënaqësinë tonë në raport me paraqitjen e statistikave dhe shqetësimet e komuniteteve në raport me përfaqësimin e komuniteteve në Administratën Publike.

Gjatë kësaj kohe, gjatë kësaj periudhe, edhe në vitin 2015 edhe gjatë vitit 2016, gjatë hartimit të raportit janë vërejtur jashtëzakonisht të meta apo mangësi në raport me implementimin e këtij neni. Ky nen është jashtëzakonisht i mirë dhe i arsyeshëm dhe shteti i Kosovës ka siguruar hapësirë, që edhe në bazë të Ligjit dhe Rregullores 04/2010, që të ndër marrë masa afirmative në punësimin e komuniteteve në proporcion me komunitetet që janë në Kosovë.

Vetëm ua rikujtoj që në tërë Administratën Publike në nivel qendror janë vetëm 4 egjiptianë të punësuar, ndërsa bredhin rrugëve rreth 300 ose 400 që janë me fakultete, ndërsa mbi 900 janë të komunitetit serb. E dimë që situata edhe politike dhe raportet tona në vend dhe gjendja e parasheh një avancim të komunitetit serb, por besoj që këtë diferencë mbi 900 me 4 mendoj se nuk është e rrugës që në këtë formë të promovohen komunitetet, sepse qysh në preambulë dhe në Kushtetutë dhe në të gjitha ligjet e Kosovës është paraparë që popujt të trajtohen të barabartë. Në rast se, ka mundësi punësimi barabartë, në kushte të barabarta, me përgatitje të barabartë të të gjithëve në Kosovë, atëherë mendoj që këtu ka hapësirë që të veprohet dhe njerëzit të trajtohen të barabartë.

Unë e përshëndes zotin ministër që është i pranishëm, zotin Jagxhillar, dhe ka qenë po ashtu bashkëpunues edhe gjatë raportit që ka qenë pikërisht për nenin 11 dhe besoj se rekomandimet e dala nga ai raport do të futen edhe në raportin e Këshillit për vitin 2016, sepse në këtë raport ne nuk i kemi këto statistika.

Vetë fakti i mundësisë dhe i krijimit të nenit 11 dhe rregullores specifike për implementimin e këtij neni, ne akoma s'po vërejmë mekanizma të cilat kjo rregullore i parasheh, që të promovojmë konkurse të cilat janë publike, që të thërrasin njerëzit në konkurs barabartë, që të trajtohen barabartë edhe në konkurse dhe të marrin masa afirmative për grupe të caktuara, të cilat vërtet duhet të jenë pjesë e Administratës Publike.

Në anën tjetër, ka të mbipopulluar në ministri të caktuara, të cilat do të duhej të ishin të barabartë, po i referohem Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal dhe shumë ministri të tjera, të cilat vërtet janë të mbipopulluara, sidomos me komunitetin serb.

Absolutisht, s'jemi kundër askujt, por vërtet këto ministri janë të Kosovës, për këto ministri kontribuojmë secili dhe do të duhej të ishim aty. Vetë Kuvendi i Kosovës, vetë Administrata e Kuvendit të Kosovës nuk ka arritur akoma ta përfillë këtë nen dhe këtë ligj, akoma nuk ka mundësi dhe s'gjendet hapësirë, edhe pse kemi pasur premtime qysh nga fillimi, që të fillohet nga Kuvendi i Kosovës dhe vërtet nuk e di sa ka kuptim të kërkohet nga institucionet tjera që ky

nen të implementohet. Ne në shumicën e ministrive nuk kemi, kështu që ftoj ministrin që të kontribuojë në këtë aspekt, të bashkëpunojmë, të gjejmë mekanizma, të gjendet rrugë. Mendoj se nuk është problemi te ligji, sepse në ligj thuhet qartë se duhet që minimumi të pranohen 10% të komuniteteve. Aq më keq, në komunat e Kosovës ekzistojnë disa zyra komunale për komunitete, ato zyra u dedikohen decidivisht komuniteteve dhe, më besoni ose jo, në 80% të rasteve në këto zyra nuk janë komunitete pakicë të punësuarit. Janë statistikatat të cilat do t'i prezantojmë në Kuvend dhe vërtet do të bindeni dhe ta shikoni gjendjen reale.

Ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë në këtë aspekt, sepse është përhapur në opinion se “këto komunitete nuk kanë kuadro të përgatitura”. Ne jemi të gatshëm në çfarëdo forme të kontribuojmë dhe të jemi të trajtuar të barabartë në këtë sferë. Po mundohem që edhe përmes rekomandimeve edhe përmes këtij, që njëherë e përgjithmonë, sepse nuk është hera e parë që diskutohet për përfaqësimin e komuniteteve, mendoj se është e pesta prej se unë jam në këtë mandat dhe askush fare nuk merret me çështjet tona.

Domethënë, ligji kërkon implementim, nëse ekziston baza ligjore atëherë cilat janë arsyet që mos të implementohet? Mendoj se duhet pak edhe vullnet politik edhe nga kryeministri edhe nga ministrat, sepse po ka hapësirë për komunitete të caktuara që të ketë vullnet politik. Kanë ardhur statistikatat tona, të cilat në të cilat referohet se nga komunitete të caktuara ka edhe në zyrë të kryeministrit për komunitete, ndërsa atje s'figurojnë fare. Edhe këtu duhet të kemi kujdes, sepse njerëzit përfitojnë nga këto raste dhe nuk do të duheshim të lejojmë.

Unë e ftoj ministrin, po ashtu e kam edhe zëvendësministrin të komunitetit egjiptian, nga i cili kisha kërkuar që të ketë më tepër hapësirë dhe të kontribuojë në këtë çështje, që komuniteti egjiptian të mos mbetet që 15 vjet me 4 të punësuar në krejt nivelin qendror, sepse mendoj se e kemi merituar që të jemi më të pozicionuar, më të favorshëm dhe në pozicion më të mirë. S'po kërkojmë asgjë tjetër, jo lëmoshë, jo mëshirë, por na jepni mundësi që ne të jemi të barabartë dhe të trajtohemi për aq sa ne mund të kontribuojmë. Nuk duam më mëshirë, dëshirojmë të jemi të angazhuar dhe besoj që edhe do të kontribuoj me rekomandime dhe të jenë të implementueshme. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Sot kur po shqyrtojmë raportin për shërbyes civilë për vitin 2015. Kanë kaluar pra, shumë vjet prej kur Ligji për shërbyes civilë pra, që është miratuar në vitin 2011. Qysh në mandatin e kaluar, zoti ministër, është ndërë nevoja, sepse nuk ka gjetur zbatim, kjo po përmendet edhe sot nga deputetët në fjalë. Pra, është kërkuar nevoja urgjente e plotësim-ndryshimit të këtij ligji. Ju, qysh në mandatin e kaluar vazhdimisht na keni thënë edhe në komision kur kemi qenë atëherë, që ky ligj së shpejti do të vijë në plotësim-ndryshim.

Pra, sot jemi në vitin 2016 dhe ky ligj ende nuk është, pra ende nuk ka ardhur në komision për tu plotësuar-ndryshuar. Prandaj, edhe moszbatimi i tij është pikërisht në hartimin e këtij ligji, qysh në vitin 2015, kur janë bërë shumë gabime. Ky ligj, pra e kemi përmendur edhe në mandatin e kaluar, që nuk i definon qartë kategoritë, siç janë drejtorët e shkollave, drejtorët e klinikave, nuk i definon pra se janë shërbyes civilë apo nuk janë.

Prandaj, duke parë edhe punën e këshillit si kategori kushtetuese dhe zbatimin e vendimeve të tij, që po injorohen qoftë nga niveli qendror apo lokal, pra ky është shqetësimi i vazhdueshëm që ka qenë në Kuvend dhe është edhe sot e kësaj dite, nga se kryetarët e komunave, pra u përmendën disa komuna, po e përmend edhe komunën e Gjakovës, që nuk i zbaton vendimet e Këshillit, që janë vendime të prera. Andaj, detyrohen personat që tu drejtohen edhe gjykatave, ngase edhe Gjykata Themelore, për shembull, ka kthyer një prej vendimeve prapë në harmoni me vendimin e Këshillit për Shërbyes Civilë, por detyrohen t'i dërgojnë në Gjykata apeli duke ditur që shumë lëndë presin pra për tu zbatuar, për tu punuar në fakt nga gjykatat në fjalë edhe dihen problemet dhe mungesa e stafit në këto gjykata.

Prandaj, asnjëherë nuk u morën seriozisht vendimet e këtij këshilli unë konsideroj që këshilli në objektin ku punon nuk është në objektin e duhur konsideroj që kushtet dhe hapësirat e këtij këshilli duhet të shikohen, nga se edhe paga besa e vet anëtarëve në këshill nuk është në nivelin e duhur, nga se në qoftë se ti me pagën minimale çfarë e ke në fakt edhe këto moszbatimet e këtyre vendimeve nga përgjegjësit e nivelit lokal dhe qendror ju thuhet se ju kaq po vleni nga se edhe pagat e këtyre anëtarëve, pra të këshillit janë minimale krahasuar me kategoritë tjera që janë në nivelin e njëjtë pra, si kategori kushtetuese.

Andaj, këto vendime këto vendime të këshillit duhet të merren shumë seriozisht nga se nuk po ndëshkohen personat në fjalë ose institucionet të cilat nuk po i respektojnë këto vendime dhe në fund të fundit, çfarë po vijmë në përfundim se thjesht po dëmtohet buxheti në nivelin lokal apo në nivelin qendror dhe shumë herë, me vite të tëra kemi parë se janë paguar dy paga, një nga ai që është i punësuar, politikisht, konsideroj, sepse edhe administrata publike në nivel lokal dhe qendror është më se e mbingarkuar. Kjo është përmendur vazhdimisht edhe në Raportin e Progresit, prandaj me militantë partiakë dhe në fund të fundit buxheti po dëmtohet. Pra, ka me 3-4 vjet që detyrohet buxheti qoftë i nivelit lokal apo i nivelit qendror në shumë vende, pra edhe në shumë ministri që t'u paguhen pagat personave që ankohen dhe thjesht i fitojnë edhe të gjitha shkallët nëpër gjykata dhe rezultati është pra, edhe një herë po them, dëmtim i buxhetit.

Prandaj, nevojë urgjente është plotësim-ndryshimi i këtij ligji, jo ministër, të thoni se ka tash 4 a 5 vjet që ju e përmendni, sepse keni qenë ministër edhe në mandatin e kaluar po i të njëjtës ministri, andaj në qoftë se ishin ndërruar ministrat shumë herë ndodh që ministrat e kthejnë punën mbrapsht nga paraardhësi i tij dhe, në fakt, ju keni qenë po ai ministër, andaj ishte dashur të punoni dhe ta bini ligjin në plotësim-ndryshim, t'i definoni qartë edhe kategoritë, pra siç i

përmenda në fjalë, e njëkohësisht edhe të bëni nivelimin e pagave, ngase nuk po zbatohen rregulloret në fjalë, por ka edhe rregullore të tjera dhe se ligji është nevojë urgjente, pra në plotësim-ndryshim, kurse ka edhe shumë rregullore që janë nxjerrë dhe nuk po zbatohen dhe konsideroj se nuk është një punë serioze, nuk është një punë e mirë që ka ndodhur, por në fakt është një mospunë dhe një papërgjegjshmëri, andaj nëse personat në fjalë ose ministrat nuk janë të aftë ose nuk janë profesionalisht të aftë dhe nuk janë të zotë për ta zbatuar ligjin, atëherë është më mirë që thjesht të japin dorëheqje dhe t'ua lënë personave që janë më të gatshëm, që janë më profesionalë dhe që janë të guximshëm për të marrë vendime edhe në momente të dhura, pra që janë në nevojë dhe në interes të qytetarëve të vendit.

KRYESUESI: Diskutuesja e fundit është Emilija Rexhepi! Le të ftohen deputetët të kthehen në sallë.

EMILILJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Poštovani predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

Već u svom drugom mandatu govorimo o zaposlenosti manjinskih zajednica u javnim institucijama odnosno o problemu gde se u kontinuitetu krši Ustav Republike Kosova i Zakon o civilnoj službi oko zaposlenosti manjinskih zajednica u svim javnim institucijama, kako na centralnom tako i na lokalnom nivou.

Kao Ministarstvo za javnu administraciju, kao krovna mreža Vlade naše koja bi trebala kontrolisati kako funkcioniše ceo taj sistem, je u obavezi da kontroliše i izveštaj od 2015 godine, koji nema statističke podatke i nadam se da će preporuke koje ćemo danas doneti iz ovog Parlamenta, uvaženi ministar to i ispoštovati.

Međutim, sistem je takav da već u kontinuitetu nekoliko godina se ovo narušava. Zašto ovo govorim? Govorim iz iskustva koga imamo na lokalnom nivou zato što Bošnjačka zajednica ima i problem nostrifikacije diploma.

Gospodo, narodni poslanici, Bošnjačka zajednica nije eksperiment da neko na nama vrši razne primere, da li će se nostrifikovati diplome ili verifikovati, a neka druga zajednica može bez problema u ovim institucijama raditi. I naši studenti koji su završili sa tim diplomama su koje su validne i priznate svuda, ne bi trebalo da u samom startu budu diskriminisani da konkurišu za bilo kakvu vrstu posla za koju su završili svoju stručnu spremu.

Takođe, jedan od gorućih problema jeste da oni ljudi, odnosno radnici koji već rade u javnim institucijama a pri kraju su svog staža odnosno idu u penzije na njihova radna mesta se takođe zapošljavaju pripadnici drugih zajednica, što je još gorući problem.

Ono što bi zahtevala od ministra Jakdžilara, znači bez obzira koji je ministar, jeste da Ministarstvo za javnu administraciju prati zaposlenost svih ljudi i njihovu etničku pripadnost tokom zapošljavanja, a pre svega želim da se ispoštuje Ustav Republike Kosovo i Zakon o zapošljavanju manjinskih zajednica, koji nam dozvoljava da se uposlamo u svim javnim institucijama u 10% u zavisnosti o broju zajednica gde one žive.

Takođe, ono što je bitno, jeste da afirmativno Vlada deluje na pripadnike manjinskih zajednica da se na što bolji način njima pruži šansa da se integrišu u ovo društvo. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

E nderuar ministre,

Falënderoj për debatin e gjithashtu edhe për sugjerime dhe plotësime sa i përket gjendjes së Shërbimit Civil.

Ligji i shërbimit civil dhe gjendja e Shërbimit Civil nuk prezanton vetëm punën e Ministrisë së Administratës Publike, prezanton punën e të gjitha institucioneve, duke filluar nga niveli lokal e ato qendrore, por gjithashtu edhe qeveritare dhe institucioneve të tjera, të cilat janë edhe jashtë Qeverisë, faktikisht për të cilat janë përbrenda shërbimit civil.

Edhe unë jam dakord se shumica e pyetjeve janë temë për të cilën duhet të bisedojmë për ndryshimin ose hartimin e ligjit të ri, të cilin pas pak do ta prezantoj se në cilën fazë jemi.

Edhe kjo është një bindje se a duhet të decentralizojmë shërbimin civil apo ta centralizojmë. Në qoftë se kërkohet centralizimi, atëherë sipas ligjit duhet t'i japim kompetenca ose Ministrisë së Administratës Publike ose një institucioni tjetër, i cili duhet të emërohet me ligj. Sepse, në këtë rast, te procedurat e rekrutimit janë situata të qarta sipas ligjit dhe çdo institucion e rregullon rekrutimin.

Edhe në këtë rast te rekrutimi, pastaj Ministria e Administratës Publike nuk ka asnjë përgjegjësi. Lënda shkon me ankimimin menjëherë te Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës Civil dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës Civil vepron dhe nxjerr vendimin.

Pastaj, për realizimin e vendimit, prapë Ministria e Administratës Publike nuk ka asnjë kompetencë. Kompetenca është e Këshillit, gjyqit dhe informimit të Parlamentit ose zyrtarëve të tjerë shtetërorë dhe ajo zbatohet.

Në këtë rast, te Ministria e Administratës Publike nuk mbetet ndonjë kompetencë.

Dhe, në qoftë se dëshirojmë të bëjmë centralizimin, duhet të bisedojmë për ligjin dhe si t'i rregullojmë këto çështje.

Te pranimi. A do të bëhet me një pranim për të gjithë, me një provim pranues, apo të bëjmë prapë në aspektin e decentralizuar.

Këto janë çështje të cilat duhet të bisedojmë dhe besoj që do të bisedojmë gjatë hartimit të ligjit.

Sa i përket ligjit, ligji është dashur këtë vit të propozohet në Qeveri dhe në Parlament, por në takime me Komisionin Evropian për reformën e administratës publike është kërkuar që tri ligjet, Ligji për shërbimin civil, Ligji për organizimin e administratës publike dhe Ligji për pagat nga buxheti i Republikës së Kosovës të rishqyrtohen e të hartohen koncept dokumente të reja dhe së bashku me tri ligjet të procedohen në Qeveri, e pastaj në Parlament dhe të jetë një harmoni mes ligjeve: Ligjit për organizimin, Ligjit për pagat dhe Ligjit për shërbimin civil.

Ne jemi duke punuar dhe së shpejti do të procedojmë koncept dokumente të reja për këto tri ligje, dhe duke u bazuar edhe në këto diskutime të sotme që ligji të jetë sa më efikas, por së bashku duhet të bisedojmë se a dëshirojmë një centralizim pak më të madh në Ligjin e shërbimit civil apo do të vazhdojmë kështu me një decentralizim, por gjithashtu besoj se jenë në dijeni se ka edhe disa kërkesa nga institucionet e pavarura kushtetuese që administrata publike të jetë jashtë shërbimit civil. Dhe me ligjin e ri, besoj se këto çështje duhet të qartësohen.

Në këtë aspekt, kemi nevojë për ndryshimin e ligjit dhe besojmë se do ta zbatojmë.

Sa i përket pagës dhe vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës Civil, është një këshill, i cili është jashtë ndikimit të Qeverisë. Më shumë është ndërlidhur me Kuvendin.

Sa i përket punësimit të komuniteteve, ekziston edhe raporti i cili është përgatitur nga komisioni, për çka së bashku punuam. Në raportin e gjendjes civile janë të gjitha të dhënat, të përmbledhura nga institucionet.

Vetëm ministri i Administratës Publike i ka përpunuar këto të dhëna. Por, me funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, sepse është raport për vitin e kaluar, por për këtë vit deri në fund të vitit besojmë se sistemi do të jetë i kompletuar dhe do të kemi të gjithë informatat të skanuara dhe të dërguara zyrtarisht nga çdo institucion dhe në sistem do të kemi çdo moment të gjithë informatat sa i përket pozitës, sa i përket shkollimit dhe çështjeve të tjera të nevojshme.

Sa i përket shkollimit, edhe unë jam i shqetësuar, sepse ende në shërbimin civil shihet se ka shërbyes civilë me shkollë fillore, por ata janë të bartur prej viteve, por ndoshta edhe te gabimi i interpretimit të ligjit, sepse në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore ende nuk i kemi plotësuar të gjithë emrat e mbiemrat. Mund të ndodhë që ata janë trajtuar më herët si shërbyes civilë, por tash janë si staf mbështetës.

Në këto çështje i kemi qartësuar me Këshillin dhe të gjithë ata persona të cilët janë në stafin mbështetës më nuk do të përfshihen në shërbimin civil dhe nuk do të jenë pjesë e raportit.

Në këtë aspekt unë mendoj që në të ardhmen duhet të punojmë së bashku dhe mund të konkludohet se ka përmirësime në menaxhimin e shërbimit civil, por duhet vazhduar me angazhime në përmirësimin e raporteve nga institucionet, por edhe nga Ministria e Administratës Publike.

Zbatimi i klasifikimit të vendeve të punës dhe përdorimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore është i duhur.

Të bëhet ruajtja e administratës publike si një trup i shërbimit civil unik;

Mbikëqyrja më efektive e zbatimit të Ligjit të shërbimit civil nga ana e të gjitha institucioneve;

Ndalimi i praktikës së organizimit të institucioneve me ligje të veçanta, pa harmonizim me Ligjin e administratës shtetërore dhe shërbimit civil.

Gjithashtu zbatimi i Ligjit për paga të nëpunësve civilë të realizohet ose të aprovohet ligji i ri për paga nga buxheti.

Gjithashtu plotësimi ose ndryshimi i ligjit të shërbimit civil, me mekanizma të cilët do të mundësojnë kontrollin dhe hartimin e analizave të aprovimit të ligjit të ri për organizimin e administratës publike, i cili do të krijojë një qartësi sa i përket organizimit.

Në këtë aspekt, unë prapë, edhe një herë falënderoj për kontributin dhe besoj që edhe këto çështje do të inkuadrohen në raport, por do të jenë edhe pjesë koncept-dokumenti të hartimi i Ligjit për shërbimin civil dhe ligjeve të tjera si ai i organizimit të administratës publike dhe pagat nga buxheti i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deri sa të mblidhen deputetët, më lejoni t'i them dy fjalë rreth kësaj çështjeje.

Ajo që do të flas unë dhe pritja të flitet këtu, nuk është raporti për gjendjen, se ai është një dokument i propozuar. Çështja është gjendja. Tjetër është raporti për gjendjen se është bërë njëfarë tipi i shabllonit këtu - raporti është hartuar mirë, i ka kaq kapituj, i ka këto shënime. Ai është problem tjetër, mund të jetë raport i hartuar shkëlqyeshëm, e lëmi të jetë pus.

Pra, problemi është i gjendjes në shërbimin civil të Kosovës, që s'është e mirë. Dhe, pse s'është e mirë? Normalisht që nuk mund të jetë e mirë ku shteti është punësuesi kryesor në shërbimet e veta - administratë. Dhe, krejt loja pastaj kushtetore bëhet me atë tip punësimi.

Kjo i ka të gjitha nivelet e pushteteve, prej atij që është qendror i Kosovës, deri të komunave, e pastaj edhe më poshtë.

Më në fund, të bëhemi konkretë. Qeveria jonë i ka 21 ministri. Ka mundur t'i ketë 11. I ka dyfish zëvendësministra ose diku edhe trefish, për shkak të komuniteteve.

Kuvendi ynë, nëse e shihni administratën, mund të prodhohet të shkojnë 1/3 në pushim, dhe ju garantoj që pak a shumë funksionon njësoj.

Të gjitha ndërmarrjet, edhe ato publike, po edhe në nivel komunal 1/3 hiqeni, bëjeni bilancin e punës ditore, unë ju garantoj që s'ndërron shumë.

Çka i bie kjo? Kjo i bie ai mbipopullim që po e quan Veton Berisha, duke pasur parasysh vetëm një nacionalitet, po s'ka të bëjë me këtë. Kjo është dukuri dhe ju e dini shumë mirë që Kosova është e mbingarkuar me punë në administratë, që është punë e vogël.

Këtu janë bërë do sondazhe më herët dhe na i kanë bërë, e ju e dini që sondazhet thonë se në administratë njerëzit në Kosovë... Kjo s'është i këtij viti, por nuk ka ndërrua shumë puna, prej 8 orëve rrinë prej 2 deri 3 orë. Domethënë kaq rrinë, prej 8. E sa janë efektivë, është punë tjetër.

Prandaj, unë shtroj një çështje tjetër, më substanciale këtu. Nuk është problemi ligji, problemi - zbatimi. Edhe ligji ideal nëse nuk zbatohet nuk sjell dobi shumë. Dhe, nëse zbatohet mirë ai që është në fuqi, është në rregull. Pastaj korrektohet. Sepse, ligji do zbatim edhe të detyrimit të punonjësit, edhe të përgjegjësisë.

Unë mendoj se te ne, sidomos në këtë sektor, nuk është problem papunësia, por është problem koncepti tjetër, i atij që është i punësuar, por është i papunë. Dhe ky është fenomen në të gjitha strukturat e shtetit tonë, sidomos në këtë lëmi, sepse për kah natyra është e tillë.

Pra, mendoj se ka mundësi të bëhen reduktimet, por është edhe vështirë, sepse punësimet shkojnë aty ku nuk ka punë. Ai është slogan i përditshëm, por ju mund ta ndieni, ende funksionon: “E ka gjetur një punë që s’bën gjë”.

Kjo është pak a shumë logjikë edhe aktuale, edhe e trashëguar. Ju e dini që ne kemi shumë ngarkesa në ndërmarrje publike, edhe në shërbim civil, e ato po ngarkohen edhe më shumë dhe keni kujdes, unë i përmenda do shifra. Kjo vlen edhe për komuna, për sektorë, drejtori e të tjera.

Prandaj, ju keni metoda të tjera të shtimit të këtyre nëpunësve, që po i quajnë tash kontratë në vepër e metoda të tjera, të cilat janë kudo, nuk janë vetëm në një organizim.

Unë kisha nevojë t’i bëj këto venerime. Dhe atë të fundit, shkoni pa deklaruar kush jeni, lypni shërbime civile kushdo prej jush dhe e shihni cili është shërbimi. Mos e merrni shërbimin civil kur me mesitni i nxirrni dokumentet. Shkoni vetë, këqyrni, e shihni!

(Ndërhyrje)

Nuk është shkelje hiq, se ti e di që unë kam të drejtë të flas, e kjo karrige nuk lihet thatë dhe ti, të kisha thënë, e di shumë mirë, por unë ty, meqë jemi kështu, bëhu pak më humane. Kaq! Ti e di pse po ta them dhe mendoje mirë këtë. Për sot e ke. Mendo pak.

Pra, sa deputetë janë të pranishëm?

Pra, në sallë janë 63 deputetë dhe kërkoj që të kalojmë në votim, dhe do ta votojmë raportin për gjendjen në shërbimin civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe votojmë tash!

Pra, në votim kanë marrë pjesë 63 deputetë, për kanë votuar 33 deputetë, kundër kanë votuar 23 deputetë dhe kanë abstenuar 7 deputetë dhe konstatoj se Kuvendi e miratoi me shumicë të vogël votash - 33 për raportin për Shërbimin Civil.

12. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2015

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Në emër të Komisionit e ka fjalën deputetja Xhevahire Izmaqi! S’është këtu.

Fjalën e ka zëvendësi i saj, Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryesues!

Në bazë të nenit 7. 2.8 të Ligjit 04/036 për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës i paraqet përmes kryeministrit për miratim Qeverisë dhe Kuvendit raportin për zbatimin e plan-programit për shfrytëzim të mjeteve buxhetore.

Komisioni për Administratë Publike e Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur me 16. 8. 2016 shqyrtoi raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2015 dhe vlerësoi se raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 7.2.8 të Ligjit për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupet parlamentare të deklarohen. Për Grupin e PDK-së, Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar ministra e deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka trajtuar me kujdes raportin vjetor për vitin 2015 të Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe mbështet punën që e kanë bërë ekspertët e Agjencisë dhe njëherësh i falënderojmë të gjithë donatorët që e kanë mbështetur në vazhdimësi këtë Agjenci, e cila ka rëndësi të veçantë për vendin tonë, sepse bazë e çdo zhvillimi në Kosovë, duke përfshirë edhe investimet e brendshme dhe të jashtme është raporti i statistikave.

Ne duhet të mbështesim edhe më tutje këtë agjenci, sidomos në sfidat që ka para veti dhe duhet të trajtojmë me kujdes buxhetin e kësaj agjencie për ngritje të kapaciteteve profesionale me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe sasisë së të dhënave statistikore.

Ky raport në vete mban të dhëna të rëndësishme statistikore, si në statistikën ekonomike dhe llogaritë kombëtare, në statistikën sociale, statistikën bujqësore e të mjedisit, dhe përmban në vete projektin e bujqësisë dhe të dhëna të tjera sociale ekonomike, janë të dhëna të rëndësishme që mban raportin dhe shihet një ngritje e kapaciteteve të agjencisë nga raportet vjetore të publikuara.

Ky është raporti i katërt dhe përmban një punë të madhe që e ka Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Prandaj, duke parë se kemi një rritje të produkteve, gjegjësisht publikimet statistikore, performansa nga pikëpamja e prodhimit statistikor është më e lartë në raport me vitet paraprake dhe tregon se kemi zhvillim të kapaciteteve menaxheriale.

Ne e kemi konsideruar të drejtë rekomandimin e Komisionit parlamentar dhe duke parë se ky raport është në pajtim me Ligjin për statistikën zyrtare në Republikën e Kosovës, dhe si Grup Parlamentar e mbështesim këtë raport dhe i ftojmë kolegët ta votojnë. Faleminderit.

KRYESUESI: Për LDK-në kush flet? Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah rekomandimin e Komisionit Funkcional dhe po ashtu konstaton se publikimet e kësaj Agjencie shumë të rëndësishme po vijnë duke u rritur e gjithashtu edhe cilësia e këtyre publikimeve po vjen duke u rritur, por ne mendojmë që në tri pika shumë të rëndësishme për ngritjen e cilësisë së qeverisjes makroekonomike dhe qeverisjes ekonomike në Kosovë ka hapësirë shumë të madhe për përmirësim.

Së pari janë statistikat kombëtare, statistikat e GDP-së, që do të thotë se tash për tash është përmirësuar dhe publikohet edhe për tremujor, gjë që është një arritje e tij. Mirëpo, nuk publikohet me rregull e në mënyrë cilësore statistika sipas veprimtarive ekonomike, e kjo është shumë me rëndësi për të parë dhe ndjekur prioritetet e zhvillimit.

Problemi serioz, dhe ndoshta ndër më serioz është se ende nuk kemi publikim të statistikave për prodhimin industrial dhe shërbimet në Kosovë, vëllimin e prodhimit dhe vëllimin e shërbimeve. Për shembull, ne nuk mund të gjejmë statistika tona sa prodhohet qumësht në Kosovë, sa prodhohet lëngje në Kosovë ose produkte të tjera të ngjashme për të ndjekur më mirë zhvillimin apo riindustrializimin e vendit.

E treta. Ne kemi probleme me statistikat e punësimit. Nuk kemi ende statistika sa njerëz punojnë në Kosovë, në cilët sektorë punojnë, sa njerëz hyjnë brenda vitit në punë në Kosovë. Dhe, në qoftë se kemi problem rritjen e eksportit dhe në qoftë se kemi prioritet, në fakt, rritjen e eksportit përmes zhvillimit të prodhimit vendor dhe rritjen e punësimit, ne patjetër duhet ta ndryshojmë këtë gjendje.

Ne kemi diskutuar edhe më herët dhe kemi propozuar masa, kurse Agjencia e Statistikave ankohet për buxhetin dhe stafin që është goxha në moshë dhe është vështirë t'i përcjellë zhvillimet e reja në këtë fushë.

Unë mendoj se në buxhetin e ardhshëm patjetër duhet të krijohet një hapësirë që statistikat kombëtare lidhur me GDP-në, statistikat e prodhimit industrial, statistikat e shërbimeve dhe statistikat e punësimeve duhet të arrijnë një përmirësim substancial. Ato mund të arrihen me ristrukturimin e njerëzve, sepse më shumë njerëz punojnë në sektorë ku nuk janë aq të rëndësishme statistikat, se sa në këto katër sektorët që unë i përmenda. Do të thotë, nevojitet një ristrukturim ndoshta i njerëzve që punojnë aty brenda dhe koncentrim i tyre në këto katër fusha të rëndësishme, e para.

Dhe, e dyta, sigurisht se nevojitet edhe një analizë me buxhet, për të parë se a mjafton buxheti për këtë institucion, kështu që sigurisht në diskutimet për buxhetin e ardhshëm të vitit 2017 kjo çështje e meriton një vëmendje të madhe.

Me këto propozime ne mbështesim raportin dhe po ashtu kërkojmë që Komisioni Funkcional dhe Komisioni i Zhvillimit Ekonomik ta ndjekin këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Për Grupin e Lëvizjes “Vetëvendosje” flet Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Agjencia e Statistikave të Kosovës është një institucion shumë i rëndësishëm dhe raportet që ata prodhojnë do të duhet të ishin baza mandej për hartimin e çfarëdo lloj planifikimi, qoftë për Qeverinë apo qoftë edhe për institucionet e tjera.

Është hera e parë që ne po e shqyrtojmë raportin e Agjencisë së Statistikave, ndonëse me ligj ata kanë pasur për obligim ta bëjnë edhe viteve të mëhershme.

Natyrisht, për të parë se a ka shënuar progres apo jo kjo agjenci në punën e saj, mua më ishte dashur të shoh që përveç të lexoj raportin e këtij viti, të lexoj dhe raportin e një viti të mëhershëm, do të thotë të vitit 2014. Dhe më besoni se më është dashur ta lexoj tejet me vëmendje për t’i gjetur ndryshimet në mes të raportit të vitit 2014 dhe raportit të vitit 2015.

Unë mund të ju them lirisht se të paktën deri në faqe 10, dhe po filloj nga hyrja, është identik. Është i njëjti, është fjalë për fjalë i kopjuar nga viti 2014 në vitin 2015. Ndryshimi i vetëm që mund ta gjeni në këtë raport janë datat.

Diçka që ata me kujdes e kanë bërë. Do të thotë, i kanë ndryshuar datat e raportit nga viti 2014 në vitin 2015, për derisa përmbajtja është pothuajse identike.

Natyrisht se me një lexim të vëmendshëm, i sheh edhe disa ndryshime të cilat kanë ndodhur në një raport. Dhe, unë po i përmend, ta zëmë, disa prej këtyre ndryshimeve.

Në mes tjerash, Agjencia raporton se sa ditë pune ka shpenzuar për hartimin e një raporti të caktuar. Dhe po i përmend dy shembuj. Njëri nga këto raporte thotë është llogari qeveritare. Në vitin 2014 Agjencia ka planifikuar se për hartimin e këtij raporti i duhen 109 ditë pune, por atë e ka mbaruar për 27 ditë pune. Nuk shpjegohet arsyeja pse paska ndodhur kaq shpejt, a e ka planifikuar keq, apo e kanë arritur punëtorët një efikasitet shumë të madh.

Por, mu për të njëjtin raport, në vitin 2015, ata i kanë planifikuar që do t’i duhen 70 ditë pune, por i është dashur mandej 131 ditë pune për ta mbaruar këtë raport.

Një tjetër raport, për shembull, është Strategjia afatshkurtër e ndërmarrjeve, që zoti Mustafa e përmendi se është me rëndësi që ata të nxjerrin edhe raporte për industri e për ndërmarrje. Në vitin 2014 ata kanë planifikuar 380 ditë pune dhe këtë raport e kanë hartuar mandej për 73 ditë, por në vitin 2015, ndonëse e kanë pasur përvojën e një viti më herët, kur do të thotë e kanë kryer për 73 ditë, ata kanë planifikuar 324 ditë pune dhe e kanë mbaruar këtë raport për vetëm 6 ditë pune.

Tash nuk e dimë se çfarë ka ndodhur, sepse në këtë raport nuk jepen shpjegime, nuk jepen detaje të tjera se si ka rrjedhur apo si e kanë kryer punën e vet.

Pra, përveç se ky raport nuk tregon asgjë përmbajtjesore rreth mënyrës së funksionimit të Agjencisë së Statistikave, mënyrës së menaxhimit të saj, objektivave që ky institucion ka synuar për t'i arritur dhe si i tillë nuk jep mundësi për të analizuar punën e këtij institucioni.

Por, çështja më shqetësuese në gjithë raportin është raporti financiar. Janë 3 rreshta përmes të cilëve agjencia raporton se si i ka harxhuar 1,2 milion euro. Është e ndarë në paga e mëditje, mallra e shërbime dhe të tjera, por nuk shpjegohet asnjëherë se sa dhe çfarë janë këto mallra e shërbime, për të cilat agjencia ka shpenzuar mjete të nevojshme.

Një aktivitet i cili nuk ka munguar aspak në Agjencinë e Statistikave janë vizitat studimore. Vetëm në Luksemburg punëtorët e Agjencisë së Statistikave kanë shkuar plot 97 herë brenda vitit. Do të thotë, brenda 260 ditë pune, afërsisht sa i ka një vit kalendarik, 394 ditë këta punëtorë i kanë kaluar nëpër vizita studimore dhe trajnime.

E thashë, Luksemburgu duket të ketë qenë vendi më i preferuar i tyre, pasi e kanë vizituar rreth 100 herë.

Por, më poshtë nuk jepet asnjë shpjegim. Çfarë kanë qenë këto vizita studimore, kush ka marrë pjesë në këto vizita studimore, cilat kanë qenë përvojat që janë marrë nga këto vizita studimore, sa është rritur performansa e agjencisë pasi ata janë kthyer nga këto vizita ku kanë marrë përvoja të caktuara.

Përveç vizitave studimore, agjencia ka harxhuar një pjesë të madhe të mjeteve edhe në trajnime, të cilat i ka ndjekur, e nuk e dimë, në fakt, a i kanë ndjekur punëtorët apo menaxhmenti i kësaj agjencie, sepse prapë nuk jepet asnjë shpjegim sa janë bërë këto trajnime, kush i ka ndjekur dhe, mbi të gjitha, cilat janë rezultatet e punës së këtyre punëtorëve pasi ata i kanë ndjekur këto trajnime.

Prandaj, si i tillë raporti jo vetëm që nuk meriton përkrahjen tonë, por ngre për mua të paktën edhe një shqetësim tjetër. Nëse agjencia nuk ka arritur të hartojë një raport cilësor për punën e

vet e t'i raportojë Kuvendit si e ka kryer punën e vet, sa ka shpenzuar dhe si i ka shpenzuar mjetet, si mund t'i marrim për të besueshme pastaj raportet e tjera, të cilat kjo agjenci i harton e mbi të cilat do të duhej të bazohen planifikime të rëndësishme të institucioneve të ndryshme të vendit.

Prandaj, unë mendoj që ky raport nuk e meriton përkrahjen e deputetëve dhe, për më tepër, duhet të shihet më në detaje se çfarë është bërë brenda këtij institucioni dhe sidomos cilësia e raporteve që ata i kanë prodhuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Pal Lekaj, shef i Grupit të AAK-së, e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesues,

Të nderuar kolegë,

Sa i përket raportit të Agjencisë për Statistika mendoj se është një segment i rëndësishëm i planifikimit dhe i zhvillimit të çdo resursi. Ajo që më bie në sy në këtë raport është se ka kopje nga viti paraprak dhe pothuajse është identik dhe nuk mund të vlerësoh një performansë çfarë duhet ta ketë kjo agjenci, sepse gjithçka niset nga statistikat. Dhe e thashë, kur jemi te statistikat, nëse nuk kemi saktësi, atëherë edhe dështimet janë evidente.

Prandaj, nëse nisemi nga ky raport, sa u përket produkteve dhe zhvillimit ekonomik, mendoj se nuk korrespondon me situatën aktuale.

Një sqarim po e jap këtu. Nëse Banka Botërore e thotë qartë se kemi rënie të investimeve, dhe kjo ndikon në zhvillimin ekonomik në këtë tremujorin e dytë të këtij viti, ndërsa në këtë raport thuaja se gjithçka është në rregull dhe po u servohet parlamentarëve apo deputetëve të Parlamentit të Kosovës diçka që gjithçka me ne është në rregull, që nuk është ashtu.

Prandaj, unë mendoj që duhet të jemi më serioz me vetveten, sepse nëse bazohemi në këto statistika të dhëna, mendoj se edhe dështimi i Qeverisë do të jetë evident.

Dhe ne në këtë drejtim, kërkojmë që kur raportohet për diçka që është bazë e çdo gjëje që niset nga A deri në Zh të këtyre departamenteve, mendoj se duhet të jemi shumë më konkretë dhe duhet të jemi më realë me atë që ndodh në terren. Faleminderit!

KRYESUESI: Zafir Berisha, për Grupin e "Nismës për Kosovën", e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Ne kemi përvoja jo shumë të këndshme nga agjencitë dhe jo vetëm nga kjo, por të gjitha agjencitë që i raportojnë Kuvendit dhe unë fjalimin dua ta nis nga kolegët e mazhorancës.

Këtu është fjala për raportin, jo për rëndësinë e Agjencisë. Në fakt, të mos ishte e rëndësishme agjencia, nuk do të themelohej. Prandaj këtu duhet bërë një dallim.

Këtu ka vërejtje substanciale. Zoti kryesues, në raportin e mëhershëm u përqendruat në vërejtje substanciale të shërbyesit civilë dhe po shpresoj se ke votuar kundër sikur ne edhe ti meqë ishte kundër kësaj situate të shërbyesit civilë, po edhe në këtë rast.

Agjencitë që i paraqesin raport Kuvendit, zoti kryesues, në mënyrë detale duhet të analizohen, sepse ne symbyllur duke i mbështetur këto raporte keqpërdorimeve të parasë publike, ku duhet të fokusohemi, do të thotë u japim përparësi dhe po i miratojmë me dorën tonë.

Ne kemi përgjegjësi të tjera si deputetë dhe unë mendoj që para se të marr qëndrim çdo deputet, në këtë rast edhe të mazhorancës, duhet futur në atë çfarë është thelbësore.

Rëndësia e agjencisë po kuptohet. Problemi është se mjetet të cilat derdhen për këtë njësi buxhetore nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, do të thotë si shpenzohen, ka statistika në mënyrë formale për çështje të tjera, por në data-baza nuk ka statistika për shpenzimin e atyre mjeteve, që janë 1 milion e 200 mijë euro.

Prandaj unë mendoj se sikur edhe disa raporte të tjera, edhe ky raport duhet të votohet kundër.

Fillimisht për vetëdijesim të agjencisë dhe të menaxhmentit të kësaj agjencie me shpresën që e kam thënë edhe në raste të tjera, kur janë debatuar raportet e agjencive të ndryshme, se ne në mënyrë urgjente si Kuvend duhet marrë masa për të ndryshuar ligje dhe përmes ligjeve për të ngritur përgjegjësinë dhe llogaridhënien e njerëzve nëpër agjenci dhe njësi të tjera buxhetore që i raportojnë Kuvendit.

Nuk është shumë korrekte, pa dashur t'i përsëris ato që janë thënë në seanca të tjera, se kemi agjenci dhe njësi buxhetore të cilat me vite të tëra nuk i kalojnë raportet dhe të njëjtit njerëz vazhdojnë të menaxhojnë. Thjesht, Kuvendi nuk duhet të bie në nivelin e keqpërdorimit të parasë publike, si mungesë e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, t'i japim mundësi që të vazhdojë edhe më tutje.

Në emër të “Nismës” ne votojmë kundër këtij raporti. Dhe, zoti kryesues, u fol më herët për shërbyesit civilë dhe thënë të drejtën, këta shërbyesit civilë brenda Kuvendit nuk e dinë që akronimi i “Nismës për Kosovën” nuk është NK, dhe bëre e nuk reagoje, e bëjnë NN, kështu që akronim yni atje në ekran është “Nisma”. Faleminderit!

KRYESUESI: “Nisma”! Kërkoj falje! Shërbyesit civilë atëherë le ta ndreqin, unë për vete ju kërkoj falje dhe mendova se ashtu e keni emrin. Nëse e kam thënë keq, e ke faljen. Të lutem!

Atëherë, Duda Balje për Grupin “6+” e ka fjalën.

DUDA BALJE: Hvala!

Svakako da jedna ovakva vrsta izveštaja Statističkog zavoda Kosova potrebna svim onima koji se ozbiljnije žele baviti i bave se bilo kakvim poslovima ovde na Kosovo.

Što se tiče ovog izveštaja, uz sve manjkavosti koje smo do sada čuli i po mišljenju Parlamentarne grupe “6+” možda bi samo trebalo da se poveća fond informacija koje se nudi sa različitih aspekata.

Parlamentarna grupa će podržati ovaj izveštaj uz nadu da će sledeće godine ovaj izveštaj biti daleko temeljniji. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Të gjithë në emër të grupeve janë deklaruar. Kemi edhe 3 deputetë. Deputetja Melihate Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Mendoj se e njoh goxha mirë punën dhe gjendjen në këtë agjenci dhe në njëfarë mënyre i jap vetes të drejtë ndoshta për t’i thënë edhe disa gjëra, që në njëfarë mënyre u thanë edhe nga kolegët e tjerë.

Po e them shumë hapur, kur dihet se kush e drejton këtë agjenci, ky raport po më duket tepër i mirë, falë edhe disa punonjësve, të cilët punojnë me njëfarë përkushtimi, e që janë shumë pak.

Fatkeqësisht jo vetëm në këtë agjenci, por edhe në shumë agjenci të tjera, që themelohen për arsye krejtësisht profesionale, e udhëhiqen nga njerëz totalisht politikë dhe joprofesionalë, njerëz jokompetentë. Prandaj, s’ka si të jetë gjendja ndryshe edhe në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, kur dihet që udhëhiqet nga njerëz shumë joprofesionalë, jokompetentë e për të mos thënë edhe diçka tjetër.

Pra, kemi të bëjmë me punësime politike, totalisht politike, në vende ku kërkohet punë shumë profesionale, ku kërkohet përgatitje jashtëzakonisht e lartë profesionale.

Pse Qeveria nuk po merret me këtë çështje, si dhe me do agjenci të tjera, nuk e di. Në fakt, e di, por nuk e di! Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Derisa e kemi përpara raportin vjetor të vitit 2015 të kësaj agjencie, pa dashur t'i përsëris shumë prej fjalëve që i thanë kolegët, do të ndalem pak në një faqe, ose në hyrje të këtij raporti, që thotë - raporti vjetor nga ana e kësaj agjencie bëhet për herë të katërt, sipas obligimit ligjor nga neni 7.2.8 e Ligjit për statistikën.

Ky raport ndryshon nga raporti i rregullt vjetor, ashtu siç u tha më parë. Ky raport nuk ndryshon me përjashtim të shumë çështjeve që u përmendën lidhur me stafin, ndoshta, për udhëtimet zyrtare ose shpenzimet që i ka bërë ky raport.

Por unë po e ngre edhe një çështje tjetër. Në qoftë se i shohim sfidat që i ka paraqitur ky raport, sfida kryesore, thotë gjatë vitit 2015 ishte finalizimi i projektit të regjistrimit të bujqësisë për vitin 2014 dhe realizimi i planit vjetor 2015, kurse që në fillim thuhet: në vitin 2015 është finalizuar projekti i regjistrimit të bujqësisë.

Pra, e shihni se komplet ndesh bie ajo që është shkruar në raport. Në fund thotë: mungesë kryesore ose sfidë kryesore është mosregjistrimi i bujqësisë, kurse në fillim thotë është realizuar dhe finalizuar projekti i regjistrimit të bujqësisë, kur ne e dimë se nuk është realizuar dhe asnjëherë nuk është tentuar të bëhet regjistrimi i bujqësisë në katër komunat veriore. Pra, asnjëherë nuk ka pasur ndonjë tentim dhe këtu ka dështuar komplet, jo vetëm kjo agjenci, por edhe Qeveria e Republikës së Kosovës në krye me zotin Mustafa.

Gjithashtu është përmendur në sfida mungesa e buxhetit, siç u tha, dhe e stafit, përderisa u përmend që shumë vizita kanë ndodhur dhe asnjëherë këto vizita si vizita studimore nuk mjaftuan që ky staf, thjesht, të jetë më profesional dhe më i përgjegjshëm për të paraqitur raporte siç është dashur edhe të paraqiten.

Megjithatë, unë konsideroj se ky raport e sheh si të arritur të veten, aq sa nuk ishte dashur të ndodhë, është përmendur kohë më parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës tendenca e Qeverisë së Republikës së Kosovës që të bëhet një ligj për regjistrimin e popullsisë në komunat veriore dhe është kundërshtuar fuqishëm nga kolegja Tërmmkolli që unë them edhe një herë se e kam përcjellë atë seancë dhe duhet ta kemi vëmendjen në këtë çështje për të mos ndodhur asnjëherë, kurse te ky raport thotë se agjencia ka përgatitur koncept dokumentet e plotësimit të Ligjit për statistikën zyrtare dhe Projektligjit për regjistrimin e popullsisë në katër komunat veriore, që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011.

Pra, edhe me këtë raport edhe një herë tendenca e fuqishme për të ndarë këto katër komuna me qëllim të pastër, ashtu sikur që është në çdo aspekt dhe në çdo segment të kësaj Qeverie të Republikës së Kosovës haptazi, pa bërë një ndarje dhe kjo agjenci nuk ka arritur, meqë është mekanizëm i dalë nga zyra e kryeministrit dhe nuk ka arritur të kryejë punën e vet, pra që në fillim, qysh në vitin 2011, por në fakt, edhe ky raport le që është i mangët, por thjesht ka

divergjenca aq të mëdha në vetë raportin e tyre, dhe kjo ndodh për shkak se është bërë, siç u tha edhe më herët, përshkrim i raport dhe nuk kanë ditur thjesht se çka po shkruajnë në këtë raport.

Prandaj, është një shqetësim për Kuvendin e Republikës së Kosovës për këto agjenci të papërgjegjshme, të cilat, në fakt, bëjnë vetëm përshkrime të raporteve dhe nuk ndikojnë asnjëherë në cilësinë dhe punën që ishte dashur ta kryejnë këto institucione që janë të ngritura për çështjet në fjalë.

Pra, edhe një herë, ky raport nuk meriton të përkrahet, atëherë normal se edhe do ta ketë votën kundër, prandaj edhe një herë duhet të ngrihet çështja - çka me raportet që nuk po miratohen në Kuvend?

Në vazhdimësi është përmendur dhe asnjëherë askush nuk po e merr përgjegjësinë. Raportet të cilat nuk po votohen në Kuvend ose thjesht dokumentet që i kam përmendur edhe në seanca të kaluara, dokumentet e Kuvendit, të nderuar kolegë deputetë, nuk po respektohen prej Qeverisë së Kosovës. Raportet të cilat nuk po miratohen, askush s'po ndëshkohet. Dhe, çka po bëjmë ne si Kuvend? Për asnjë dokumentet nuk merret seriozisht Qeveria e Kosovës me dokumente që nxirren në Kuvend.

Asnjë nga raportet që nuk miratohen në Kuvend, pra që nuk miratohet në Kuvend dhe po e potencoj, nuk ndëshkohet askush. Çka Kuvendi, ku është Kuvendi, cila është puna e Kuvendit, cili është roli i Kuvendit në këtë rast? Kemi rënë nën ndikimin, fatkeqësisht, të Qeverisë, në këtë rast Mustafa, por njëkohësisht më duhet të them edhe në qeveritë e kaluara, pra roli i Kuvendit nuk është duke luajtur rolin e vet. Thjesht, nuk po respektohet, nuk ka vullnet dhe atëherë nëse vullnet nuk ka, dokumentet nuk respektohen, e çfarë pune po bëjmë ne? Bëjmë debate, flasim dhe në fund të fundit nuk vendoset asgjë. Ku është çështja e këtyre raporteve, kush po ndëshkohet? Askush!

KRYESUESI: Mytaher Haskuka e ka fjalën dhe është i fundit. Lus deputetët të hyjnë brenda, të votojmë dhe të shkojmë në drekë.

MYTAHER HASKUKA: Pa dashur të marr shumë kohë, desha t'i bëj disa komente lidhur me këtë raport.

Së pari, unë nuk e kisha këtë raport në kutinë time e as nuk e mora me e-mail, u desh ta marr nga kolegët e ta lexoj, dhe besoj edhe deputetë të tjerë nuk e kanë marrë raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, e ndoshta është dërguar më herët, por ne s'e kemi marrë.

Në atë aspekt duhet shikuar para se të vijmë në votim raportet t'i kemi ato e t'i shqyrtojmë mirëfilli.

Ndoshta qëllimi kryesor ka qenë edhe të mos shqyrtohet ky raport, nga se nëse shikojmë raportin, është me të vërtetë katastrofë. Të kishte qenë në universitet, ky raport, unë e kisha konsideruar si plagjiat e as si temë e diplomës nuk e kisha kaluar të ndonjë studenti sikur të kishte pasur kësi kopjimi sikur është nga raporti paraprak.

Do të thotë, po më vjen keq të konstatoj diçka të tillë për një institucion kaq të rëndësishëm sikur që është Agjencia e Statistikave të Kosovës, e cila ka pasur aq shumë investime, përveç nga vendorët, por edhe nga agjencitë dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe prapë, pas të gjitha atyre investimeve kemi raporte të tilla joprofesionale dhe raporte të tilla, të cilët faktikisht e përsërisin njëra-tjetrën vit pas viti.

Për t'i ilustruar këto që janë faktikisht kopjim i raporteve paraprake, do ta lexoj si shembull një pjesë që deri në faqen 7 asnjë ndryshim nuk ka ndërmjet raportit të vitit 2015 dhe 2014 dhe desha të ilustroj këtu për deputetët e tjerë, të cilët ndoshta s'kanë pasur kohë t'i lexojnë këto dy raporte.

Për shembull, në faqen 7 të raportit 2014 thotë se gjatë vitit 2014 funksionalizimi i KS-së ka pasur pengesa për shkak të dorëheqjeve të kryetarëve të KS-së si dhe mospjesëmarrjes së rregullt të disa anëtarëve të këtij Këshilli.

Raporti i 2015-ës thotë: Gjatë vitit 2015 funksionimi i KS-së ka vazhduar të ketë pengesa për shkak të dorëheqjes së kryetarit të KS-së, sidomos pas mospjesëmarrjes së rregullt të anëtarëve të këtij Këshilli. Do të thotë pikërisht njëjtë, por vetëm këtu dallon kryetarja me kryetarët. Pastaj vazhdon: ASK-ja këto probleme i ka adresuar sipas ligjit të statistikave të institucioneve përkatëse, ndërsa në raportin 2015 thotë: sipas Ligjit të statistikave zyrtare, ASK-ja problemet e paraqitura i ka adresuar te institucionet përkatëse. Do të thotë vetëm ndryshimi i vendit të fjalëve dhe kështu vazhdon thuajse i gjithë raporti. Do të thotë edhe figurat në raporte veç kanë ndryshuar në aspektin vizual, ndërsa brendësia e tyre ka mbetur e njëjtë dhe nuk ka kurrfarë ndryshimi të raporteve paraprake të Agjencisë së Statistikave, e kështu me radhë.

Një koment përfundimtar, desha të them se Agjencia e Statistikave është shumë me rëndësi, nga se për të ditur gjendjen ekonomike, sociale dhe në të gjitha sferat e jetës, ne na duhen statistika të mira dhe të besueshme. Ndërsa, nëse e shikojmë këtë raport ashtu siç është, ne si t'u besojmë këtyre statistikave që prodhohen nga kjo agjenci.

Do të thotë në atë aspekt mendoj se ka shumë njerëz të aftë aty në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, të cilët e dinë punën e tyre dhe janë profesionalë, por nëse nuk mbështeten nga udhëheqja dhe Qeveria, normal se ata do të prodhojnë kësi raportesh, të cilët nuk janë në njëfarë aspekti as profesional, por as në nivel të rëndësisë së institucionit të cilit i përket.

Prandaj, unë i thërras edhe deputetët e tjerë, të cilët ndoshta s'kanë pasur kohë ta lexojnë, të mos e votojnë këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Diskutimi u krye dhe para se të votojmë për këtë ne, të merremi veç, sepse e kemi edhe një pikë të rendit të ditës, që është e dhjeta, e që e shtymë për dy pika, sepse kërkesa e grupeve ishte që deputetët që janë nëpër komisione tash kanë ardhur.

Pra, a jeni ju për të vazhduar me atë votim, apo të japim pushim dreke dhe të vazhdojmë më pas, sepse ju e dini që sot e kemi edhe një seancë të re, e cila vazhdon pas kësaj. Atëherë, ju lutem, bëhuni gati për të votuar pikën 12: Raporti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2015.

Janë prezentë 62 deputetë dhe votojmë tash! Kanë votuar 62 deputetë. Për kanë votuar 29 deputetë, kundër 30 dhe kanë abstenuar 3 deputetë dhe konstatoj se Kuvendi nuk e miratoi raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Tash kemi pauzë një orë për drekë!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë!
Kemi qenë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Zgjedhja e një anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Nga procesi i votimit askush s'ka mundur të fitojë. Rezultatit e kemi marrë, duke pasur parasysh se aktualisht në sallë nuk kemi kuorum të mjaftueshëm për të proceduar me votimin, sepse janë 47 deputetë.

Prandaj, do të kisha kërkuar mirëkuptimin tuaj që ta mbyllim këtë pikë të rendit të ditës, në fakt që i bie të mbyllet edhe seanca, për të vazhduar këtë seancë në një moment më të përshtatshëm, për të vazhduar me seancë të radhës, po ashtu sot.

A e miratoni këtë propozim? Faleminderit!

Atëherë, meqë kemi mirëkuptim lidhur me këtë, i mbyll punimet e kësaj seance plenare për të vazhduar me seancën e jashtëzakonshme. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*